

SARAH DESSEN
KJO NINULLĚ
ROMAN

BOTIMET TOENA

SARAH DESSEN

KJO NINULLË

roman

Përktheu nga origjinali anglisht

Enkeleida Haxhinasto

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Autorja: Sarah Dessen (Sara Desen)

Titulli në origjinal: This lullaby

Botoi në anglisht: Viking Children's Books, një filial i Penguin Young Readers Group, divizion i Penguin Random House LLC.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-235-41-1

© Sarah Dessen, 2002

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Lexojeni një herë dhe do të dashuroheni me të

Vetëm fillimi

- Mendoj se ti më pëlqen, - më tha teksa i shkela këmbën duke i shkakuar një hungërimë dhimbjeje. Vijova rrugën.

- Mendim i gabuar, - iu përgjigja më në fund, duke vështruar Xhesin në një kabinë telefonike në qoshe të rrugës, me kokën të mbështetur mbi njërin bërryl. Dukej e mërzitur. Kur më pa, ngriti lart të dyja duart duke nënkuptuar me gjestin e saj “Çfarë dreqin do ai?”. Unë, thjesht, tunda kokën.

- Kush është ky djali? - thirri Kloe prapa meje.

- Askushi, - i thashë.

- Dekster, - u përgjigj ai, duke u kthyer paksa për t’i dhënë dorën, megjithëse ende vijonte të ecte me një hap me mua. - Si je?

- Mirë, - ia ktheu ajo si me bezdi. - Remi?

- Vijo rrugën! - i thirra, teksa kaloja pranë dy djemve me gërsheta të hollë. - Do ta humbë shpejt interesin.

- Oh, nuk besoj, - u përgjigj me ngazëllim. - Ky është vetëm fillimi.



“Remi dhe Deksteri (veçanërisht Deksteri) kërcejnë nga faqet e librit në zemrat e lexuesve, që do ta ëndërronin këtë histori dashurie.”

*Në acarin e dimrit,
më në fund kam mësuar
se brenda meje gjendej
një verë e pacenuar.*

Camus

*Ajo do të kthehet së shpejti.
Ajo thjesht po shkruan.*

Caroline

Qershor

Kreu i parë

Titulli i këngës është “*Kjo ninullë*”. Mund ta kem dëgjuar ndoshta një milion herë. Përafërsisht.

Gjatë gjithë jetës sime më kanë thënë se babai im e shkroi ditën kur linda unë. Ishte diku në një udhëtim në Teksas. Në atë kohë ishte ndarë nga mami im. Pasi mori lajmin për lindjen time, u ul me kitarën e tij dhe e krijoi këngën atje, në një dhomë në *Motelin 6*. Iu desh vetëm një orë, pak korda, dy strofa dhe një refren. Kishte shkruar muzikë tërë jetën e tij, por kjo ishte e vetmja këngë që e bëri të njohur. Deri në fund të jetës së tij, babi e arriti vetëm një herë suksesin. Ose dy herë, nëse do të më numëronit edhe mua.

Ishte java e parë e qershorit. Po e dëgjoja këngën e ulur në një karrige plastike te dyqani i makinave. Moti ishte ngrohur, çdo gjë po lulëzonte dhe vera thuhajse kishte filluar. Kjo, natyrisht, nënkuptonte se kishte ardhur koha që mami im të martohej sërish.

Ishte hera e saj e katërt, ose e pesta, nëse do të përfshinit edhe babin tim në listë. Por unë zgjodha të mos e bëj. Sipas saj, ata ishin martuar, nëse mund të quhet martesë bashkimi i dy njerëzve në mes të shkretëtirës nga dikush që e kishin takuar vetëm pak minuta më parë, teksa ishin ndalur me

makinë për të pushuar. Por atëherë, ajo i ndërronte burrat për të njëjtat arsye që femrat ndërrojnë ngjyrën e flokëve: mërzi-tja, humbja e interesit ose thjesht mendimi se tjetri do të rregullojë gjithçka, një herë e mirë. Kur isha më e vogël, kur e pyesja për babin dhe si ishin takuar, kur vërtet isha ende kureshtarë, ajo vetëm psherëtinte duke tundur dorën e duke më thënë: “*Oh, Remi, ishin vitet shtatëdhjetë. Kupton?*”.

Mami im gjithnjë mendon se unë di çdo gjë. Por gabohet. Gjithçka që di për vitet shtatëdhjetë është çfarë kam mësuar në shkollë dhe nga Kanali i Historisë në televizor: Vietnami, Presidenti Karter, disko. Dhe gjithçka dija për babin tim, në të vërtetë, ishte “*Kjo ninullë*”. Gjatë jetës sime e kisha dëgjuar në sfond të reklamave dhe filmave, nëpër dasma, në paradën e këngëve më të pëlqyera në radio, dedikuar dashurisë në distancë. Babai im ka vdekur, por kënga e tij sentimentale vazhdon të jetojë. Ajo, madje, do të jetojë më gjatë se unë.

Në mes të refrenit të dytë, Don Devisi i dyqanit të makinave nxori kokën nga zyra e tij dhe më pa.

- Remi, zemër, më vjen keq që të lashë të prisje. Hajde brenda!

U ngrita dhe hyra pas tij. Për tetë ditë Doni do të bëhej njerku im, duke iu bashkuar një grupi jo dhe aq të veçantë. Ai ishte i pari tregtar makinash, i dyti me shenjën e binjakëve, i vetmi me pará të vetat. Ai dhe mami im u takuan mu aty, në zyrën e tij, kur erdhëm të blinim një makinë të re *Camry* për të. E shoqërova sepse e njoh mirë mamin tim. Ajo do ta paguante në çast çmimin e katalogut, duke menduar se ishte i pandryshueshëm, sikur të ishte duke blerë portokaj apo letër higjienike në një dyqan ushqimesh. Dhe, natyrisht, ata gati ishin, sepse mami im ishte disi e njohur dhe të gjithë mendonin se ishte e pasur.

Shitësi ynë i parë dukej sikur sapo kishte mbaruar universitetin dhe gati sa nuk pësoi infarkt kur mami shkoi duke vallëzuar vals drejt një modeli të fundit tepër të shtrenjtë. Ajo futi kokën brenda për të ndier erën e makinës së re. U gëlltit, buzëqeshi dhe tha si me mburrje: “*Do ta marr!*”.

“*Mami!*”, i thirra duke u përpjekur të mos kërcëlloja dhëmbët. Por, ajo i dinte vetë gjërat. Gjatë gjithë rrugës në makinë, e kisha përgatitur mirë me të gjitha instruksionet specifike: çfarë duhet të thoshte, si duhet të sillej, pra gjithçka që duhet të bënim për të siguruar një pazar të mirë. Më thoshte se po më dëgjonte, edhe pse vazhdonte të eglendisej me kondicionerin e makinës apo me dritaret e mia automatike. Bëj be se kjo i kishte shkaktuar në të vërtetë ethet e saj për një makinë të re: fakti që unë sapo kisha blerë një të tillë.

Kështu, pasi e kishte djallësuar fare punën, më takonte mua të merrja në dorë situatën. Fillova t’i bëj pyetje të drejtpërdrejta shitësit. Ai u nervozua. Vazhdonte t’i hidhte vështrime të shpejta mamit që ndodhej pas meje, sikur unë të isha ndonjë lloj qeni i stërvitur për sulm, që vetëm ajo mund ta qetësonte. Jam mësuar tashmë me këtë. Por, pikërisht kur ai filloi të na mundonte, biseda jonë u ndërpre nga vetë Don Deivisi, i cili na futi menjëherë në zyrën e tij dhe nuk iu deshën më tepër se pesëmbëdhjetë minuta për t’u dashuruar marrëzisht me mamin tim. Ata qëndronin të ulur atje duke parë njëri-tjetrin në sy, ndërsa unë arrita t’ia ul çmimin tre mijë dollarë duke përfshirë në çmim servis, një veshje izoluese si dhe ndryshuesin e CD-ve. Ky duhet të ishte pazari më i shkëlqyer në historinë e *Toyota*-s, por, se mos e vuri re njeri. Thjesht, pritej që kjo të ndodhte. Pritet që unë të përballoj çdo gjë, sepse jam menaxherja personale

e mamit tim, terapistja dhe shërbyesja e saj, e tashmë edhe organizatorja e dasmës së saj. Lum si unë, lum si unë!

- Atëherë, Remi, - tha Doni teksa u ulëm, ai në karrigen e tij rrotulluese, të madhe e prej lëkure, unë, përballë, në karrigen "*qëllimisht të parehatshme për të përshpejtuar shitjen*". Çdo gjë në biznesin e tyre ishte përpunuar me kujdes për t'ia bërë mendjen çorap klientëve. Si për shembull, memorandumet që u drejtoheshin shitësve, ku inkurajoheshin pazare të favorshme që thjesht "*liheshin*" rastësisht atje ku ti mund t'i lexoje apo mënyra si ishin rregulluar zyrat që ty mund të të "*kapte veshi*" fare mirë negocimin që po bënte shitësi me menaxherin e tij për një ulje të mirë. Shtojmë këtu edhe faktin që dritarja përballë meje ishte me pamje nga ajo pjesë e dyqanit ku njerëzit merrnin makinat e tyre të reja. Çdo pak minuta, njëri nga shitësit do të shoqëronte dikë mu në qendër të panoramës që ti shihje nga dritarja, do t'i dorëzonte çelësat e rinj e të ndritshëm e më pas do t'i buzëqeshte me dashamirësi kur ai të largohej me makinën e re, teksa dielli po perëndonte, tamam si në reklama. E kush i ha këto?

Doni u rregullua në karrigen e tij, duke drejtuar kollaren. Ishte i bëshëm, me bark të bollshëm dhe i kishin rënë paksa flokët. Por ai e adhuronte mamin tim. Zoti e ndihmoftë!

- Çfarë të duhet sot nga unë?

- Po, - u përgjigja duke kërkuar në xhep listën që kisha marrë me vete. - U lidha sërish me dyqanin e kostumit dhe të presin këtë javë për provën përfundimtare. Lista për darkën para dasmës, pothuajse, është mbyllur me shtatëdhjetë e pesë persona dhe përgjegjësit të banketit do t'i duhet të hënë një çek për pjesën e mbetur të pagesës.

- Në rregull. Hapi një sirtar dhe nxori dosjen prej lëkure ku mbante bllokun e çeqeve, pastaj kërkoi në xhepin e xhakëtës për një stilolaps. - Sa duhen për banketin?

Ula sytë te letra ime, u gëlltita dhe i thashë:

- Pesë mijë.

Miratoi me kokë dhe nisi të shkruante. Për Donin pesë mijë dollarë nuk ishin asgjë. Për këtë dasmë do t'i duhej një njëzetëshe e mirë, por as kjo nuk dukej se e shqetësonte, aspak. Shtoji kësaj edhe restaurimin që i kishte bërë shtëpisë sonë, në mënyrë që të jetonim të gjithë së bashku si një familje e lumtur, borxhin që kishte falur për kamionin e vëllait tim si dhe sigurimin e jetesës së përditshme me mamin tim. Po bënte goxha investim. Kjo ishte dasma e tij e parë, martesë e parë. Ai ishte fillestar, ndërsa mami im tashmë mund të quhej profesioniste.

Nxori çekun, e vuri mbi tryezë përpara meje dhe buzëqeshi.

- Çfarë të duhet tjetër? - më pyeti.

Pashë sërish listën.

- Them se vetëm problemi i orkestrës na ka mbetur. Ata që po merren me organizimin e pritjes më pyetën...

- Atë e kam zgjidhur, - tha duke tundur dorën. - Orkestra do të vijë. Thuaji mami të mos shqetësohet.

Buzëqesha, sepse ai po e priste diçka të tillë nga unë, por që të dy e dinim se ajo nuk po merakosej aspak për këtë dasmë. Kishte zgjedhur fustanin dhe lulet, ndërsa të tjerat m'i kishte lënë mua, duke pretenduar se i nevojitej absolutisht çdo sekondë e lirë për të punuar me librin e saj të fundit. Në të vërtetë mami i urrente detajet. Asaj i pëlqente të zhytej në projekte, të merrej me to për nja 10 minuta, por pastaj e humbte interesin. Në shtëpinë tonë mund të gjeje ngado grumbuj të vegjël gjërash që dikur kishin tërhequr vëmendjen e saj: kutitë e aromaterapisë, programi kompjuterik i pemës gjenealogjike, një kopicë librash gatimi japonez, një akvarium me katër faqe të

mbuluara me alga dhe me vetëm një të mbijetuar, një peshk i madh i bardhë që i kishte ngrënë gjithë të tjerët.

Shumica e njerëzve e shpjegojnë sjelljen e çuditshme të mamit me faktin se është shkrimtare, sikur kjo të sqaronte gjithçka. Për mua, ky është vetëm një justifikim. Dua të them, që edhe kirurgët e trurit mund të jenë të çmendur, por askush nuk thotë që kjo është normale. Fatmirësisht, për mamim tim, jam e vetmja me këtë opinion.

- ... është kaq shpejt! - tha Doni, duke prekur me gishta kalendarin. - E beson dot?

- Jo, - iu përgjigja, duke vrarë mendjen se cila mund të kishte qenë pjesa e parë e fjalisë së tij dhe shtova: - Shumë e çuditshme.

Më buzëqeshi dhe pastaj uli sërish sytë te kalendari, ku tashmë dallova ditën e dasmës, 10 qershor, të rrethuar disa herë me ngjyra të ndryshme stilolapsash. Nuk kishte faj që ishte kaq i emocionuar. Para se të njihej me mamanë time, Doni ishte në moshën kur shumica e shokëve të tij i kishin humbur shpresat se ai mund të martohej ndonjëherë. Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit kishte jetuar i vetëm, në një apartament në autostradë, duke punuar gjatë tërë kohës dhe kishte shitur më tepër makina *Toyota* se kushdo tjetër në shtetin tonë. Ndërsa tani, për nëntë ditë, ai nuk do të merrte vetëm Barbara Starin, romancieren e jashtëzakonshme të historive të dashurisë, por të përfshirë në paketë ishim edhe unë me vëllanë tim, Krisin. Ishte shumë i lumtur për këtë. I dukej si një mrekulli.

Në këtë çast ra zilja e telefonit të brendshëm, që ndodhej mbi tryezën e tij të punës dhe u dëgjua zëri i një gruaje.

- Don, Xhejsëni ka gati një tetëqind e pesëdhjetë e shtatë dhe i duhet ndihma jote. A t'i fus brenda?

Doni më hodhi një vështrim të shpejtë, pastaj shtypi butonin dhe tha:

- Patjetër. Pas pesë sekondash.

- Tetëqind e pesëdhjetë e shtatë? - e pyeta.

- Zhargon biznesi, - tha qetësisht, duke u ngritur. Lëmoi flokët, duke mbuluar një rogë të vogël që ia vura re vetëm kur ishte i ulur. Pas tij, në anën tjetër të dritares, një shitës me fytyrë të kuqe po i jepte çelësat e makinës së re një gruaje me fëmijë të vogël. Ajo i mori e hutuar, ndërsa fëmija e kapte nga fundi, duke u përpjekur t'i tërhiqte vëmendjen. - S'dua të të përzë, por...

- Mbarova punë, - iu përgjigja duke e futur sërish listën në xhep.

- E vlerësoj vërtet gjithçka që po bën për ne, Remi, - më tha duke ardhur drejt meje. Më vendosi njëren dorë mbi sup, si babai të bijës. U përpoqa të mos sillja në mend ish-burrat e tjerë të mamit që kishin bërë të njëjtën gjë. Edhe ata kishin menduar se do të ishin të përhershëm.

- Është kënaqësi, - iu përgjigja kur hoqi dorën nga supi im dhe më hapi derën. Në paradhomë po prisnin një shitës dhe një grua e shkurtër që duhet të ishte *“tetëqind e pesëdhjetë e shtatë”*, kodi për një klient të pavendosur. Ajo shtrëngonte çantën e dorës dhe kishte veshur një këmishë fanellate me një kotele të qepur mbi të.

- Don, - shitësi nisi t'i fliste shtruar, - kjo është Ruthi dhe ne po bëjmë të pamundurën që ajo sot të marrë një makinë *Corolla* të re.

Ruthi vështroi e shqetësuar Donin, pastaj mua, e pastaj sërish Donin.

- Unë... - murmuriti ajo.

- Ruth, Ruth, - i tha Doni me ton qetësues. - Le të ulemi të gjithë së bashku një minutë e të flasim se ç'mund të bëjmë për ju. Në rregull?

- Në rregull, - përsëriti shitësi, duke e shtyrë lehtë e me kujdes përpara. - Vetëm do të bisedojmë.

- Mirë, u përgjigj Ruthi disi e pasigurt dhe u drejtua nga zyra e Donit. Teksa më kaloi pranë, më hodhi një vështrim sikur të isha edhe unë pjesë e kësaj. Gjithçka që mund të bëja ishte të mos i thosha të ikte me vrap e të mos e kthente më kokën pas.

- Remi, - tha Doni qetësisht sikur ta kishte vënë re këtë.

- Shihemi më vonë! Në rregull?

- Në rregull, - u përgjigja dhe pashë Ruthin të hynte brenda. Shitësi e drejtoi të ulej në karrigen e parehatshme përballë dritares. Në këtë çast, një çift aziatik po hipte në kamionin e ri. Të dy buzëqeshnin teksa përshtatnin ndenjëset duke admiruar pjesën e brendshme. Gruaja uli xhamin e vogël kundër diellit dhe pa veten në pasqyrë. Të dy merrnin frymë thellë teksa ndienin erën e makinës së re. Burri ndezi makinën dhe u larguan duke ia bërë me dorë shitësit. Në sfond nuk mungonte perëndimi i diellit.

- Atëherë, Ruth, - i tha Doni teksa rehatohej në karrigen e tij. Dera po mbyllej dhe tani mezi ia dalloja fytyrën. - Çfarë mund të bëj për ty që të mbetesh e kënaqur?

Kisha bërë gjysmën e rrugës për te salla e ekspozitës kur më erdhi në mend që mami më ishte lutur disa herë ta kujtoja Donin lidhur me koktejet për sonte. Redaktorja e saj e re do të ishte në qytet në mbrëmje. Ajo, gjoja, po vinte nga Atlanta dhe do të ndalonte të takohej me mamin. Por, arsyeja e vërtetë ishte se mami i detyrohej një roman botuesit të saj dhe të gjithë kishin filluar të shqetësoheshin paksa lidhur me këtë çështje.

U ktheva dhe mora për nga zyra e Donit. Dera ishte ende e mbyllur, por arrija të dëgjoja zëra që murmurisnin prapa saj.

Ora në murin përballë ishte si nëpër shkolla, me numra të zinj të mëdhenj dhe me një akrep sekondash që

lëkundej. Tashmë kishte vajtur një e një çerek. Ishte dita pas diplomimit nga shkolla e mesme dhe unë as po shkoja në plazh e as po flija si gjithë të tjerët. Në të vërtetë, po vrapoja për të kryer porosinë e dasmës, si një punonjëse me pagesë, ndërsa mamaja ime, e shtrirë në krevatin e saj të madh, me grilat e mbyllura, po bënte gjumin që pretendonte se ishte vendimtar për procesin e saj krijues.

Dhe kaq duhej për ta ndier atë... atë djegie të ngadaltë që buburit në stomakun tim. E ndieja gjithnjë kur shikoja se sa shumë anonte balanca në favor të saj. Ishte ndoshta zemërim ose çka kishte mbetur nga ulcera, ose të dyja bashkë. Muzika u bë më e fortë, sikur dikush po luante me volumin dhe gati po hidhesha në erë nga një këngë e Barbara Streisand. Kalova njëren këmbë përmbi tjetrën dhe mbylla sytë, duke i shtrënguar gishtat në krahët e karriges. *"Vetëm pak javë të tilla"*, i thashë vetes, *"dhe mora fund"*.

Në këtë çast, dikush u lëshua me forcë në karrigen në të majtën time, duke më përplasur anash në mur. Ishte tronditëse. E godita bërrylin mu te kocka dhe ndjeva një therje deri te gishtërinjtë. Befas, u nxeha keq. Shumë keq. Është e çuditshme se si vetëm një e shtyrë mund të të tërbojë.

- Ç' dreqin bëhet këtu? - thashë duke u larguar nga muri, gati për t'i prerë kokën cilitdo shitësi të shushatur që kishte vendosur të rehatohej pranë meje. Bërryli ende më dhembte. Ndjeva një nxehtësi që po më ngjitej ngadalë deri te qafa... shenja të këqija. E njihja mirë temperamentin tim.

Ktheva kokën dhe pashë që nuk ishte shitës. Ishte një djalë me flokë të zinj kaçurrelë, që kishte afërsisht moshën time e kishte veshur një bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrëportokalli të ndezur. Nuk e kuptoja përse po buzëqeshte.

- Ç' kemi? - më foli tërë gëzim. - Si po kalon?

- Si e ke hallin? - i bërtita duke fërkuar bërrylin.

- Hallin?

- Sapo më përplase në mur, trap.

Ai kapsiti sytë.

- O Zot, - tha më në fund. - Çfarë gjuhe!

Vetëm e vështrova. *“Ditë e gabuar, djalosh”*, mendova. *“Ke gjetur ditën e gabuar.”*

- E di çfarë më ndodhi? - foli ai sikur po diskutonim për motin apo politikën e botës. - Të pashë në sallën e ekspozitës. Unë isha në anën tjetër, te vitrina e gomave.

Po e shihja tërë inat. Por ai vazhdonte të fliste.

- Mendova me vete, ashtu krejt papritur, se kishim diçka të përbashkët. Një tërheqje të natyrshme. Dhe pata ndjesinë se diçka e madhe do të na ndodhte të dyve dhe që, në të vërtetë, ishte e shkruar se do të ishim së bashku.

- Dhe e kuptove gjithë këtë, - pyeta për t’u sqaruar, - te vitrina e gomave?

- Ti nuk e ndjeve diçka të tillë? - u përgjigj.

- Jo. Por ndjeva që më përplase pas murit, - thashë qetë.

- Ajo që ndodhi, - foli duke e ulur zërin e duke u përkulur më afër meje, - ishte një aksident. Një pakujdesi. Thjesht një pasojë e papërshtatshme e entuziazmit që ndjeva nga fakti se do të flisja me ty.

E vështrova sërish. Lart, dëgjohej një version i ndryshëm me kitarë i këngës së dyqanit *“Makinat e Don Deivisit”*.

- Largohu! - i thashë. Buzëqeshi përsëri, duke kaluar njërën dorë nëpër flokë. Volumi i muzikës tashmë po ngrihej gradualisht dhe altoparlanti sa nuk shpërtheu sikur ra në një qark të shkurtër. Të dy ngritëm sytë dhe pastaj pamë njëri-tjetrin.

- E di çfarë? - foli ai duke treguar me gisht lart nga altoparlanti, i cili kërciti sërish, edhe më fort kësaj here, e

pastaj fishkëlleu para se të rifillonte këngën në maksimumin e volumit. - Që sot e tutje, - tha duke treguar me gisht sërish lart, - kjo do të jetë kënga jonë.

- Oh, Zot, - thashë, dhe në atë çast shpëtova. Haleluja. Dera e zyrës së Donit u hap dhe Ruthi doli e shoqëruar nga shitësi i saj. Në duar mbante një tufë letrash dhe në fytyrën e lodhur kishte atë shikimin e shastisur të dikujt që sapo kishte harxhuar mijëra dollarë. Por, zinxhirin e çelësave, gjoja të larë me ar, e kishte marrë falas.

U ngrita dhe djali pranë meje brofi në këmbë.

- Prit, doja vetëm...

- Don, - thirra duke e shpërfillur.

- Vetëm merre këtë, - m'u lut duke më rrëmbyer dorën. E ktheu me pëllëmbën lart, pa më lënë kohë të reagoja, nxori një stilolaps nga xhepi i prapmë dhe shkroi një emër dhe një numër telefoni, në hapësirën ndërmjet gishtit tim të madh dhe gishtit tregues.

- Ti je i çmendur, - thashë teksa tërhoqa dorën, duke bërë që shifrat e fundit të fshihen e stilolapsi t'i binte nga dora. Ai u përplas me zhurmë mbi dysheme, duke u rrokullisur nën një makinë me monedhë për çamçakëzë aty afër.

- Hej, Romeo! - dikush ulëriti nga salla e ekspozitës dhe u dëgjua një shpërthim të qeshurash. - Hajde, o burrë, se do të ikim!

Ngrita sytë për ta vështruar dhe ende nuk më besohej. Ai nuk dinte të respektonte limitet. Unë ua kisha hedhur pijet në fytyrë djemve vetëm se më kishin prekur duke ecur në një klub e jo më të më tërhiqnin fort dorën, e për më tepër të shkruanin mbi të.

Ai hodhi një vështrim prapa dhe pastaj sërish nga unë.

- Do shihemi së shpejti, - më tha dhe i shkoi buza vesh më vesh.

- As mos e ço nëpër mend! - u përgjigja, por ai ishte larguar tashmë. Iu shmang kamionit dhe minifurgonit në sallën e ekspozitës dhe doli nga dera e përparme prej xhami, ku një furgon i bardhë që mblidhte klientët po qëndronte pranë trotuarit. Dera e prapme u hap dhe ai u përpoq të ngjitej, por furgoni bëri një lëvizje përpara e pastaj ndaloi sërish, duke bërë që ai të pengohej. Psherëtiu, vendosi duart mbi ijë dhe ngriti sytë lart nga qielli, pastaj e mbërtheu sërish dorezën e derës dhe nisi të ngjitej. Pikërisht në atë çast, furgoni lëvizi përsëri dhe kësaj here dikush i ra borisë. Kjo skenë u përsërit gjatë tërë rrugës te parkingu dhe shitësi në sallën e ekspozitës po qeshte mbyturazi. Dikush zgjati dorën nga dera e prapme për ta ndihmuar, por ai e shpërfilli. Gishtërinjtë u tundën lehtë në fillim e pastaj me forcë dhe më në fund, zgjati dorën dhe e kapi dorezën, duke hyrë brenda. Dera u përplas, boria ra sërish dhe furgoni uturiu, duke goditur marmitën teksa po dilte nga parkingu.

Vështrova dorën, ku me të zezë ishte shkarravitur 933-54-diçka-diçka, dhe një fjalë poshtë saj. *“Oh, Zot”*, shkrimin e dorës e kishte shkel e shko. Një D e madhe, një njollë në shkronjën e fundit. Emër koti... Dekster.

Kur arrita në shtëpi, gjëja e parë që më tërhoqi vëmendjen ishte muzika. Klasike, e fortë, që mbushte shtëpinë me oboet e përvajshme dhe violinat e harmonishme. Nga ana tjetër, aroma e qirinjve me vanilje ishte tepër e veçantë dhe e këndshme për të të tunduar. Në fund, një varg letrash të bëra shuk ishin hedhur si thërrimet e bukës së thekur nga salloni në kuzhinë e duke vazhduar deri te veranda.

“Shyqyr Zotit!”, mendova. *“Po shkruan sërish.”*

I lashë çelësat mbi tryezën pranë derës dhe u përkula për të marrë një nga copat e letrës të bëra shuk. Ndodhej te

këmbët e mia. Nisa ta hap teksa po shkoja në kuzhinë. Mami ishte shumë besëtyte dhe shkruante vetëm me makinën saj të vjetër të shkrimit që kishte marrë fund. Dikur, e merrte me vete kur shkruante artikuj mbi muzikën si bashkëpunëtore e jashtme e një gazete në San Françisko. Ishte e zhurmshe, kishte një zile tringëlluese që tingëllonte sa herë ajo arrinte në fundin e rreshtit dhe dukej si një mbetje nga koha e “*Postës me Kuaj*”. Ajo kishte një kompjuter të ri fringo dhe nga më të shtrenjtët, por e përdorte vetëm për të luajtur lojën me letra “Solitaire”.

Faqja në dorën time kishte numrin 1 lart në qoshen e djathtë dhe niste me shijen tipike të mamit tim.

“Melania ka qenë gjithnjë tipi i femrës që i pëlqen sfidat. Në karrierën e saj, në dashuritë dhe shpirtin e saj, ajo gjendej përballë diçkaje që i kundërvihet, i vinte në provë vendosmërinë, duke ia bërë suksesin edhe më të ëmbël. Tek ecte në hotel “Plaza”, një ditë të ftohtë nëntori, hoqi shallin nga koka dhe shkundi shiun nga flokët. Nuk e kishte pasur në plan të takohej me Brok Dobin. Për herë të fundit e kishte parë në Pragë, ku i kishin lënë gjërat po aq keq sa edhe i kishin nisur. Por, tani, një vit më vonë, kur dasma e saj ishte fare pranë, ai ishte kthyer në qytet. Dhe ajo kish ardhur ta takonte. Këtë herë, do të fitonte ajo. Ishte...”

Ishte... çfarë? Kishte vetëm një njollë boje pas fjalës së fundit, që shkonte deri në fund të faqes.

Vazhdova të mblidhja letrat e flakura teksa ecja. Ato nuk ndryshonin shumë. Në njërën, ngjarjet e romanit zhvilloheshin në L.A., jo në Nju-Jork, ndërsa në një tjetër, Brok Dobini bëhej Dok Brobini, e pastaj ndërroheshin sërish. Detaje të vogla këto, por mamit gjithnjë i duhej pak

kohë për të bërë nxehtjen. Kur e niste punën, të linte pa fjalë. E kishte mbaruar librin e fundit në tri javë e gjysmë dhe ishte goxha i trashë.

Muzika dhe tringëllima e makinës së shkrimit dëgjoheshin më fort kur hyra në kuzhinë, ku vëllai im, Krisi, po hekuroste një këmishë mbi tryezën e kuzhinës, pasi i kishte shtyrë në njërën anë shishet e vogla të kripës dhe piperit si dhe mbajtësen e pecetave.

- Hej, - tha ai duke larguar flokët nga fytyra. Mori hekurin, i cili fërshëllehu dhe nisi të hekuroste jakën e këmishës, duke mëshuar fort.

- Sa kohë ka që punon? - pyeta duke nxjerrë koshin e plehrave nga poshtë lavamanit e duke hedhur letrat në të.

Ngriti supet duke e lënë avullin të vërshëllente e duke shtrirë gishtat.

- Nja dy orë, besoj.

Vështrova pas tij, nëpër dhomën e ngrënies e pastaj në verandë, ku dallova mamin të përkulur mbi makinën e shkrimit dhe një qiri të ndezur pranë saj. Më dukej gjithnjë e çuditshme kur e shikoja. Përplaste fort tastet e makinës, duke e zhytur tërë trupin në të sikur nuk mund t'i nxirrte dot fjalët plotësisht. Mund të vazhdonte kështu për orë të tëra, duke përfunduar me gishtërinjtë e mpirë, me dhimbje shpine dhe me pesëdhjetë faqe të mira, që ndoshta do të ishin të mjaftueshme për ta kënaqur hëpërhë botuesen e saj në Nju-Jork.

Qëndroja e ulur në tryezë duke shfletuar shpejt e shpejt grumbullin e letrave postare pranë tasit të frutave, ndërsa Krisi e ktheu këmishën nga ana tjetër, duke e afruar hekurin me avash te kapaku i njëres mëngë. Hekuroste shumë ngadalë, deri në atë pikë sa më tepër se një herë u mata t'i jepja një të shkundur, duke parë sa kohë e gjatë iu desh

vetëm për jakën. Acarohem më pak kur shoh diçka që bëhet gabim sesa diçka që bëhet ngadalë.

- Mbrëmje e rëndësishme? - e pyeta. Ai ishte përkulur mbi këmishë, duke u fokusuar në xhepin e përparmë.

- Xhenifer-Ana ka një festë sonte, - u përgjigj. - Veshja duhet të jetë e thjeshtë, midis asaj shik dhe sport.

- Shik dhe sport?

- Domethënë, - tha ngadalë, ende i përqendruar, - jo xhinse, por as xhakete krejtësisht sportive. Kollarja nuk është e detyrueshme.

Rrotullova sytë. Gjashtë muaj më parë vëllai im nuk do të kishte qenë në gjendje t'i shpjegonte këto lloj termash që përcaktonin veshjen. Para dhjetë muajsh, ditën që mbushi njëzet e një vjeç, Krisi u arrestua në një festë, duke shitur drogë. Por ky nuk ishte kontakti i tij i parë me drejtësinë. Gjatë shkollës së mesme ishte përjashtuar dhe ripranuar disa herë. Një herë shpëtoi për fije nga dënimi me punë komunitare dhe nga një gjobë e mirë për mbajtje të një lënde të paligjshme. Por festa e dogji vërtet dhe bëri burg. Vetëm tre muaj, por kjo e trembi mjaftueshëm për të ardhur në terezi e për të gjetur një punë te “Jiffy Lube”, ku u takua me Xhenifer-Anën, kur ajo solli makinën e saj *Saturn* për një kontroll pas tridhjetë mijë miljesh.

Xhenifer-Ana ishte, siç thoshte mami im, “*hata fare*”, që nënkuptonte se nuk i trembej asnjërit prej nesh e nuk shqetësohej aspak që ne e dinim këtë. Ishte një vajzë trupvogël, bionde me flokë të gjatë e të dendur dhe finoke, megjithëse nuk na pëlqente ta prananim. Ajo kishte bërë shumë më tepër punë me vëllanë tim në gjashtë muaj, sesa kishim arritur të bënim ne në njëzet e një vjet. Tani ai vishej më mirë, punonte më shumë dhe përdorte gramatikën e duhur, duke përfshirë edhe terma të rinj e të çuditshëm si “*transmetim me anë të rrjetit radioteleviziv*”, “*ngarkoj me*

shumë detyra” apo *“shik dhe sport”*. Ajo punonte si sekretare e një kompanie mjekësh, por e quante veten *“specialiste zyre”*. Xhenifer-Ana çdo gjë e bënte të tingëllonte më bukur se ç’ ishte në të vërtetë. S’kishte shumë që më kishte kapur veshi tek e përshkruante Krisin si *“ekspert të lubrifikimit të automjeteve”*, duke e bërë punën në *“Jiffy Lube”* të dukej në të njëjtin nivel me drejtimin e NASA-s.

Krisi e hoqi këmishën nga tryeza dhe e ngriti lart, duke e shkundur paksa, ndërsa zilja e makinës së shkrimit tringëlloi sërish nga dhoma tjetër.

- Çfarë mendon?

- Mirë duket, - u përgjigja. - Megjithëse të ka shpëtuar një rrudhë e madhe në mëngën e djathtë.

I hodhi një vështrim të shpejtë dhe psherëtiu.

- Është tmerrësisht e vështirë, - tha, duke e vendosur përsëri mbi tryezë. - Nuk e kuptoj pse njerëzit i kushtojnë kaq rëndësi.

- Ndërsa unë nuk kuptoj pse ti po i kushton kaq rëndësi, - ia ktheva. - Që kur nuk të lejohet më asnjë rrudhë? Ty s’ të bënte përshtypje të vije me pantallona të shkurtra atje ku të gjithë visheshin e ngjisheshin.

- E lezetshme kjo, - u përgjigj duke varur turinjtë. - Ti nuk do ta kuptoje gjithsesi.

- Po, ke të drejtë. Më falni, Egbert, e harroj gjithnjë që ju jeni më i zgjuari.

Drejtoi këmishën, pa më vështruar.

- Ti duhet të kuptosh, - foli ngadalë, - se ç’do të thotë të duash të bësh diçka të bukur për dikë tjetër. Për hir të respektit. Për hir të dashurisë.

- Oh, Zot! - thashë.

- Pikërisht. - E ngriti këmishën përsëri. Rrudha ishte akoma aty, por s’kisha ndër mend të merresha më me të. -

Pikërisht për këtë po flas. Dhembshurinë. Marrëdhëniet. Dy gjëra që, fatkeqësisht dhe seriozisht, ty të mungojnë.

- Unë jam mbretëresha e marrëdhënieve, - iu përgjigja e indinjuar. - Kam tërë mëngjesin që merrem me organizimin e dasmës së mamasë sonë, harrove? Dhe kjo flet për dhembshurinë time të pazakontë.

- Ti, - tha duke palosur këmishën me kujdes mbi njërin krah, si kamerier, - ende nuk ke përjetuar ndonjë lloj angazhimi serioz...

- Çfarë?

- ... dhe je qarë e ankuar aq shumë për dasmën, sa zor se mund të quhet dhembshuri kjo.

Qëndroja atje në këmbë duke e vështuar e përhumbur. Kohët e fundit nuk arsyetonte më. Sikur i ishte bërë shpëlarje truri nga ndonjë kult fetar.

- Kush je ti? - e pyeta.

- Pra, dua të them, - u përgjigj qetësisht, - që jam vërtet i lumtur. Dhe uroj që një ditë të jesh edhe ti. Kështu si unë.

- E lumtur jam, - shfryva dhe, në fakt, kjo ishte e vërtetë, megjithëse tingëlloi disi e hidhur, ngaqë isha shumë e acaruar. - E lumtur, - përsërita me një zë më të qetë.

Zgjati dorën dhe më rrahu supin, sikur ai i dinte mirë gjërat.

- Shihemi më vonë! - më tha duke iu drejtuar shkallëve të kuzhinës që të çonin në dhomën e tij. E vështroja tek ikte, duke mbajtur në dorë këmishën ende të rrudhosur dhe kuptova se kisha shtrënguar dhëmbët, diçka që po e bëja shpesh kohët e fundit.

“Tring”, ra zilja e makinës së shkrimit në dhomën tjetër dhe mami filloi një tjetër rresht. Melania dhe Brok Dobini ndoshta tashmë ishin duke u ndarë zemërthyer, të paktën kështu dukej. Romanet romantike të mamit tim të linin

pa frymë, duke shpalosur vende të ndryshme ekzotike, të mbushura me karaktere që kishin gjithçka, por prapëseprapë asgjë. Pasuri, por edhe varfëri të shpirtit. E kështu me radhë.

Vajta te dera e dhomës “*me diell*” ku rrinte mami, duke u treguar e kujdesshme për të mos bërë zhurmë. E vështrova. Kur shkruante, dukej sikur ishte në një botë tjetër e neve na harronte fare. Madje kur ishim të vegjël dhe ulërinim e bërtitnim, vetëm ngrinte dorën nga ku ishte ulur, me shpinë nga ne, e ndërsa tastet e makinës së shkrimit ende kërcitnin, thoshte “*Shëëëët*”. Sikur kjo të mjaftonte për të na e mbyllur sqepin e për të na futur në botën ku ajo ndodhej në atë moment, në hotel “Plaza” apo në ndonjë plazh në Kapri, ku një grua e veshur shumë bukur po digjej për një burrë, të cilin ishte e bindur që e kish humbur përgjithmonë.

Kur unë dhe Krisi ishim në shkollë fillore, mami ishte trokë. Nuk kishte botuar ende asgjë, përveç disa artikujve në gazetë. Edhe ato ishin pakësuar kur grupet për të cilat ajo shkruante, si ai i babit tim, këngët e viteve ’70-të, apo ai që tani e quajnë “*roku klasik*”, nisën të shuhen pak e nga pak ose nuk dëgjoheshin më në radio. Filloi punë si mësuese e lëndës së të shkruarit në kolegjin publik të qytetit dhe nuk paguhej pothuajse fare. Jetonim në një varg blloqesh me apartamente të pakëndshme, me emra tillë si “Pishat e Rixhudit” dhe “Pylli me Pamje nga Liqeni”, po ku liqenet, pishat apo pyjet nuk dukeshin asgjëkund. Në atë kohë, shkruante në tavolinën e kuzhinës, zakonisht në mbrëmje ose natën vonë, por ndonjëherë edhe pasditeve. Edhe atëherë, historitë e saj ishin ekzotike. Gjithnjë merrte broshura falas nga agjencia lokale e udhëtimeve si dhe kërkonte për revistën “Gourmet” nëpër pircjet e qendrës së riciklimit dhe i përdorte në punën e saj hulumtuese. Vëllai im kishte marrë emrin e shenjtit të preferuar të mamit,

ndërsa për emrin tim ishte frymëzuar nga një markë e shtrenjtë konjaku që e kish parë të reklamuar në revistën “Harper’s Bazaar”. Pak rëndësi kishte që ne jetonim me makarona dhe djathë. Personazhet e saj pëlqenin havjarin dhe sorollateshin të veshura me pantallona *Dior*. Ne bënim pazar në dyqane të lira. Mami im gjithnjë e kishte dashuruar shkëlqimin, edhe pse nuk e kishte parë nga afër.

Unë dhe Krisi e ndërprisnim vazhdimisht kur ishte duke punuar dhe kjo e tërbonte. Më në fund, në një treg antikash, gjeti nga ato perdet e arixhinjve, që përbëheshin nga vargje të gjata me rruaza dhe e vuri në hyrje të kuzhinës. Nëse perdja ishte tërhequr mënjanë, kjo nënkuptonte që mund të hynim në kuzhinë. Por nëse ishte mbyllur, mami po punonte, kështu që neve na duhej të argëtoheshim apo të ushqeheshim diku tjetër.

Isha nja gjashtë vjeçe. Më pëlqente të qëndroja përpara perdes, të prekja me majat e gishtave rruazat e t’i shikoja të fërfërinin poshtë e lart. Ato lëshonin një tingull aq të ëmbël, si të ishin zile të vogla. Vështroja me vëmendje përmes tyre dhe dalloja mamin, por ajo tashmë dukej thuajse ekzotike, si një fallxhore apo si një zanë që krijonte magji. Dhe e tillë ishte, por unë nuk e dija atëherë.

Pjesa më e madhe e gjërave të mbetura nga vitet kur jetonim në apartament, kishin humbur me kohë ose ishin falur, por perden me rruaza e morëm me vete te “*Shtëpia e Re e Madhe*”, siç e quajtëm kur hymë në të. Ishte një nga gjërat e para që mami vuri në shtëpi, madje përpara fotografive tona të shkollës apo kopjes së pikturës së saj të preferuar të Pikasos në dhomën e ndenjjes. Kishte vënë një gozhdë që perdja të mund të hapej e të mos dukej, por tani ishte e ulur. Ishte konsumuar goxha, por ende e bënte punën e saj. U përkula më afër duke ia ngulur sytë mami.

Ende ishte e zellshme në punë dhe gishtat e saj fluturonin. Mbylla sytë dhe mbajta vesh. Ishte si një muzikë që e kisha dëgjuar tërë jetën time, madje edhe më tepër se këngën “*Kjo ninullë*”. Të gjitha këto goditje të tasteve, të gjitha ato shkronja, kaq shumë fjalë! I vura gishtat mbi rruaza dhe pashë imazhin e saj të valëzohej, sikur të ishte mbi ujë, duke u copëtuar butësisht e duke vezulluar, përpara se të shfaqej sërish si një i tërë.

Kreu i dytë

Kishte ardhur koha ta lija Xhonatanin.

- Ma thuaj edhe një herë pse po e bën këtë? - më pyeti Liza. Ishte ulur mbi shtratin tim, duke i hedhur një shikim të shpejtë disqeve të mia e duke pirë një cigare. Po e qelbte tërë dhomën, megjithëse ishte betuar se kjo nuk do të ndodhte, meqë dritarja ishte e hapur. Edhe para se ta lija, e urreja erën e keqe të duhanit, por me Lizën gjithnjë i lija gjërat të rrëshqisnin më tepër sesa do t'ia kisha lejuar vetes. Them se kushdo e ka të paktën një shoqe të tillë. - Xhonatani më pëlqen.

- Ty të gjithë të pëlqejnë, - ia ktheva, duke u përkulur më afër pasqyrës e duke kontrolluar lapsin e buzëve.

- Nuk është e vërtetë, - u përgjigj. Mori një CD dhe e ktheu për të lexuar pjesën e prapme. - Nuk më ka pëlqyer kurrë z. Miçel. Gjithnjë më shikonte gjoksin kur ngrihesha në tabelë për të bërë teoremat. Ai në fakt ua shikonte të gjithave.

- Liza, - i thashë, - shkolla e mesme mbaroi. Dhe, për më tepër, mësuesit nuk llogariten.

- Thjesht po ta them, - ma ktheu.

- Tani, - vazhdova teksa po bëja konturin e buzëve, duke e rrotulluar lapsin ngadalë, - na ka ngelur vetëm vera dhe

unë do të largohem për studime në shtator. Xhonatani... Nuk e di. Nuk ia vlen të vras mendjen për të planifikuar kohën, kur gjithsesi do të ndahemi në pak javë.

- Por edhe mund të mos ndaheni.

U përkula prapa, duke admiruar punën time dhe e errësova pak në buzën e sipërme, si për mbrëmje.

- Do të ndahemi, - i thashë. - Kur të nisem për në Stenford nuk dua të kem ngatërresa të panevojshme.

Ajo kafshoi buzën, pastaj vuri një kaçurrel të butë prapa njërit vesh dhe uli menjëherë kokën me atë shprehjen e të lënduarës që merrte gjithnjë në fytyrë këto kohët e fundit kur flisnim për fundin e verës. Zona e sigurt e Lizës ishin tetë javët e mbetura përpara se të gjitha të ndaheshim për në drejtime të ndryshme. Bëhej keq po të mendonte përtej kësaj.

- Sigurisht, - ma ktheu qetësisht. - Dua të them, pse duhet të kesh?

- Liza, - fola duke psherëtirë. - Nuk e kisha për ty. Ti e di këtë. E kisha fjalën për... - bëra me shenjë nga dera e dhomës së gjumit, paksa e hapur, përtej së cilës dëgjonim makinën e shkrimit të mamit, që ende kërciste, dhe violinat në sfond, - më kupton, apo jo?

Tundi kokën me mosbesim. Por, në të vërtetë, e dija që më kish kuptuar. Liza, ndryshe nga të gjitha ne, ishte paksa sentimentale lidhur me përfundimin e shkollës së mesme. Ajo qau me ngashërim gjatë ceremonisë së diplomimit. Në çdo fotografi dhe video ishte me sy të skuqur dhe pulla në fytyrë, duke i dhënë vetes një arsye për t'u ankuar në njëzet vitet e ardhshme. Ndërkohë, unë, Xhesi dhe Kloe mezi po prisnim të ngjiteshim në atë skenë e të rrëmbenim diplomat, të ishim të lira më në fund... Liza kishte qenë gjithnjë shumë e brishtë. Prandaj, të gjitha ishim të kujdesshme me të dhe

unë shqetësohesha shumë që do ta linim vetëm. Ajo ishte pranuar në universitetin e qytetit, me bursë të plotë, një mundësi shumë e mirë nga e cila nuk mund të hiqte dorë. Fatmirësisht, edhe i dashuri i saj, Adami, do të shkonte atje. Liza kishte planifikuar gjithçka: do të ishin të dy studentë të vitit të parë, do të jetonin në konvikt shumë afër njëri-tjetrit, do të kishin nja dy orë mësimi të përbashkëta. Tamam si shkolla e mesme, por më e madhe.

Vetëm tek e mendoja këtë, bëhesha keq. Por unë nuk isha Liza. Gjatë dy viteve të fundit kisha mbledhur tërë fuqitë e mia, e përqendruar vetëm në një gjë: të largohesha. Të nxirrja notat që më duheshin për të jetuar, më në fund, një jetë krejt timen. Nuk do të kishte më planifikime dasmash. As lidhje dashurore të katranosura. As njerë të përkohshëm. Vetëm unë dhe e ardhmja, së bashku. Tashmë kishte një fund të lumtur tek i cili mund të besoja.

Liza zgjati dorën dhe ngriti volumin e radios, duke e mbushur dhomën me një këngë ritmike që kishte një refren “*la-la-la*”. Shkova te dollapi për të ekzaminuar alternativat.

- Çfarë vishet kur do të ndahesh nga dikush? - më pyeti duke përdredhur një tufëz flokësh rreth njërit gisht. - E zeza për zi? Apo diçka e gëzueshme e gjithë ngjyra për t’ia hequr mendjen nga dhimbja? Ose ndoshta duhet të maskohesh disi që ta kesh më të lehtë të zhdukesh me shpejtësi, në rast se ata nuk e presin mirë lajmin.

- Unë për vete, - i thashë duke nxjerrë një palë pantallona të zeza e duke i rrotulluar në duart e mia, - mendoj diçka të errët që të tregon të hollë, paksa të hapur te gjoksi. Dhe të brendshme të lara.

- Ti ashtu vishesh çdo natë.

- Edhe sot është si çdo natë, - ia ktheva. E dija që e kisha diku në dollapin tim një këmishë të kuqe të pastër që më pëlqente, por nuk po e gjeja dot në ndarjen e këmishëve. Kjo do të thoshte se dikush kishte qenë aty brenda për të gërmuar. E mbaja dollapin ashtu siç mbaja çdo gjë tjetër: të pastër e të rregullt. Shtëpia e mamit ishte zakonisht rrëmujë, kështu dhoma ime ka qenë gjithnjë i vetmi vend që mund ta mbaja siç doja vetë. Pra, të rregullt, të sistemuar në mënyrë të përkryer dhe çdo gjë të ishte aty ku mund ta gjeja lehtësisht. Ndoshta dukesh pak e fiksuar. E çfarë pastaj? Të paktën, nuk isha shkatarrake e pisanjose.

- Por jo për Xhonatanin, - u përgjigj dhe, kur i hodha një vështrim të shpejtë, shtoi. - Dua të them, kjo është një natë e rëndësishme për të. Ti po e lë. Dhe ai akoma nuk e di. Ndoshta mund të jetë duke ngrënë një hamburger me djathë ose duke pastruar dhëmbët me fije dentare ose duke marrë rrobat e tij nga pastrimi kimik dhe nuk ia ka fare idenë.

Hoqa dorë nga këmisha e kuqe, duke nxjerrë një bluzë pa mëngë. Nuk dija ç't'i thosha. Po, ishte e shpifur të të linin. Por, a nuk qe më mirë të ishe i ndershëm qoftë edhe brutalisht? Të pranoje që ndjenja jote për dikë nuk do të ishte kurrë aq e fuqishme, sa të justifikonte kohën që ti vazhdoje t'ia merrje? Në të vërtetë, po i bëja një nder. Po e lija të lirë për një mundësi më të mirë. Në fakt, isha shenjtore, nëse do ta mendoje thellë këtë.

Pas gjysmë ore, kur ndalua makinën te marketi "Quik Zip", Xhesi po na priste. Si zakonisht, Kloe po vonohej.

- Hej, - i thashë, duke iu afruar. Ishte mbështetur te makina e saj si tank, një *Chevroleti* vjetër me një parakolp të varur, duke pirë një kokakola *Zip* shumë të madhe, e cila ishte bërë si drogë për ne. Kishte çmimin më të mirë në qytet, 1.59\$.

- Doni t'ju marr ndonjë gjë? - thirri Liza duke përplasur derën e saj.

- Kokakola dietetike *Zip*, - ia ktheva duke u zgjatur për të marrë lekët, por ajo tashmë po hynte brenda. - Shumë të madhe!

Tundi kokën teksa dera u mbyll prapa saj. Madje ecte e shpenguar, me duart në xhepa, e drejtuar për te gjërat e ëmbla. Liza vdiste për to. Ishte i vetmi person që njihja, që dinte të bënte dallimin midis dy ëmbëlsirave shumë të ngjashme.

- Ku është Kloe? - e pyeta Xhesin, por ajo mblodhi supet dhe madje nuk lëvizi as buzët nga pipa e futur në kokakolën e saj *Zip*. - A nuk e lamë në gjashtë fiks?

Ajo ngriti njëren vetull.

- Qetësohu, ti e përpikta! - ma ktheu duke tundur pijen e saj. Akulli u rrokullis me zhurmë duke u përzier me atë çka kishte ngelur nga lëngu. - Gjashtë është tani.

Psherëtiva dhe u mbështeta te makina e saj. E kisha plasje kur njerëzit vonoheshin. Por Kloe ishte gjithmonë pesë minuta me vonesë në një ditë "*të mirë*". Liza vinte zakonisht më herët, ndërsa Xhesi ishte Xhesi: fiks në kohën e duhur. Kishte qenë shoqja ime e ngushtë që nga klasa e pestë dhe e dija se vetëm tek ajo mund të mbështetesha gjithnjë.

Bankat tona ishin pranë njëra-tjetrës sipas sistemit alfabetik të znj. Daglas. Majk Skimeni, me hundën si shkabë, pastaj Xhesi, pastaj unë dhe në anën tjetër timen Adam Straku, që i kishte bajamet gjithnjë të infektuara. Në fakt, ne duhet të bëheshim shoqe të ngushta meqenëse rrethoheshim nga dy gogolë binjakë.

Xhesi edhe atëherë ishte trupmadhe. Nuk mund të quhej e shëndoshë. Më tepër ishte kockëmadhe, e gjatë dhe e

gjerë. Për nga trupi ia kalonte të gjithë djemve të klasës dhe ishte brutale në lojërat me top. Ajo mund të të gjuante aq fort, para se të fillonte mësimi, saqë shenja që të linte zgjaste deri në zilen e fundit. Shumë njerëz mendonin se Xhesi ishte e keqe, por e kishin gabim. Ata nuk e dinin atë që dija unë: mamaja e saj kishte vdekur atë verë dhe asaj i duhej të rriste dy vëllezërit e saj të vegjël, ndërkohë që i ati punonte me kohë të plotë në centralin elektrik. Ata ishin gjithnjë ngushtë me pará dhe Xhesi u rrit para kohe.

Dhe pas tetë vjetësh, pasi kaluam vitet e fundit të shkollës nëntëvjeçare, që ishin të tmerrshme si dhe vitet e këndshme të shkollës së mesme, ne ishim ende shoqe të ngushta. Kryesisht sepse unë dija ato gjërat për të, ndonëse nuk më tregonte gjithçka. Gjithashtu, ajo ishte e vetmja që nuk i duronte budallallëqet e mia dhe unë duhet ta respektoja këtë.

- Pa shikoni! - tha me një zë monoton, duke kryqëzuar krahët mbi krahëror. - Mbretëresha mbërriti.

Kloe ndaloi pranë nesh. Fiku makinën e saj *Mercedes* dhe uli diellmbrojtësen për të kontrolluar buzëkuqin në pasqyrë. Xhesi psherëtiu fort, por unë nuk ia vura veshin. Ajo dhe Kloe nuk përbënin më lajm. Tashmë i ngjasonin muzikës në sfond. Ne të tjerat mund ta vinim re vetëm nëse gjërat ishin vërtet të qeta ose të mërzitshme.

Kloe doli nga makina, përplasi derën dhe u afrua. Ishte bërë shumë e mirë. Si zakonisht kishte veshur pantallona të zeza, këmishë blu dhe një xhaketë shumë të bukur, që nuk ia kisha parë më parë. Mamaja e saj ishte stjuardesë dhe e fiksuar pas blerjeve. Ajo i siguronte të bijës veshjet më të fundit nga dyqanet më të mira. Në grupin tonë Kloe bënte modën.

- Ç'kemi? - tha duke i vënë flokët prapa veshit. - Ku është Liza?

Unë ia bëra me kokë nga marketi “Quik Zip”. Liza ishte te banaku, duke i dhënë muhabet djalit që po regjistronte bonbonet e saj. Ne po e vështronim, ndërkohë që i tha “*mirupafshim*” duke tundur dorën dhe doli me kutinë e bonboneve, që tashmë e kishte hapur.

- Kush do? - thirri duke buzëqeshur kur pa Kloen. - Hej! O Zot, sa xhaketë e bukur!

- Faleminderit, - u përgjigj Kloe, duke e prekur lehtë me gishtërinjtë e saj. - Është e re.

- Duhet të çuditemi? - tha Xhesi me sarkazëm.

- Dietetike është? - iu kundërpërgjigj Kloe, duke ia ngulur sytë pijes në dorën e Xhesit.

- Mirë, mirë, - i thashë. Liza më zgjati kokakolën time dietetike. Piva një gllënjë të madhe dhe po e shijoja. Ishte nektari i perëndive. Me të vërtetë. - Si e kemi planin?

- Unë duhet të takoj Adamin në gjashtë e gjysmë, - u përgjigj Liza, duke futur me shpejtësi një tjetër bonbone në gojë. - Pastaj, takohemi bashkë te “Bendo” apo kudo që të jeni.

- Kush këndon sonte te “Bendo”? - pyeti Kloe duke tundur me zhurmë çelësat.

- Nuk e di, - ia ktheu Liza. - Është një grup. Ka gjithashtu edhe një festë në “*Arbors*”, ku mund të shkojmë. Methju Rixhildi ka një fuçi të vogël birre diku dhe... Remi do të ndahet sot nga Xhonatani.

Tani, të gjitha i kthyen sytë nga unë.

- Të gjitha këto nuk do të ndodhin medoemos sipas kësaj radhe, - shtova unë.

- Pra, Xhonatani u eliminua, - qeshi Kloe, teksa nxirrte një paketë cigaresh nga xhepi i xhaketës. M'i zgjati mua, por unë tunda kokën.

- E ka lënë, - i tha Xhesi. - Harrove?

- Ajo përherë i lë gjërat, - u përgjigj Kloe. Ndezi shkrepësen, u përkul pranë saj e më pas e fiku. - Si do të reagojë ai, Remi? Do të të kundërshtojë? Do të të shfaqë dashurinë e përrjetshme?

Vetëm tunda kokën, duke e ditur se ku do të dilte.

Xhesi u zgërdhi dhe pyeti:

- Kishte veshur kostum të papërshtatshëm?

- Piu duhan në makinën e saj, - tha Kloe. - Kjo duhet të jetë.

- Ndoshta, - u hodh Liza duke shtrënguar krahun tim, - ka bërë një gabim të madh gramatikor dhe është vonuar pesëmbëdhjetë minuta.

- Oh, çfarë tmerri! - bërtiti Kloe dhe të tria ia plasën të qeshurit. Qëndroja atje, duke i duruar e duke kuptuar jo për të parën herë se merreshin vesh shumë mirë të tria vetëm kur talleshin me mua si grup.

- Na shkriticë, - thashë më në fund. - Mbase, gjithmonë kam pritur shumë nga lidhjet e mia. Por, o Zot, të paktën kisha standarde.

Kloe kishte dalë vetëm me studentë universiteti që e kishin mashtruar, Xhesi e evitonte çështjen duke mos pasur fare të dashur, ndërsa Liza... eh... Liza ishte akoma me djalin që humbi virgjërinë, kështu që nuk po e llogarisim fare. Jo se kisha ndër mend t'i thosha këto.

- Mirë, mirë, - foli Xhesi. - Çfarë do bëjmë tani?

- Liza do të shkojë të takojë Adamin, - u përgjigja. - Ti, unë dhe Kloe shkojmë në fillim te “vendi” ynë dhe pastaj te “Bendo”. Në rregull?

- Në rregull, - ma ktheu Liza. - Shihemi më vonë! - Kur ajo u largua dhe Kloe e çoi makinën te parkingu i kishës aty ngjitur, Xhesi ngriti dorën time duke picërruar sytë.

- Ç'është ky? Numër telefoni? - më pyeti. Ula sytë dhe pashë shkronjat e zeza, disi të prishura, por ende aty mbi pëllëmbën time. Do ta laja para se të dilja nga shtëpia, por më doli nga mendja.

- Nuk është asgjë, - u përgjigja. - Ma shkroi një i çmendur që takova sot.

- Ah, ti që thyen zemra...

U rrasëm në makinën e Xhesit, unë përpara, Kloe prapa. Ajo vari turinjtë teksa shtyu mënjatë një kanistër lavanderie plot me rroba, një kaskë futbollit dhe disa gjunjëse të vëllezërve të Xhesit, por nuk tha asgjë. Kloe dhe Xhesi mund të kishin mosmarrëveshjet e tyre, por ajo e dinte kur nuk duhej kaluar masa.

- Te "vendi"? - më pyeti Xhesi dhe ndezi makinën. Pohova me kokë. Ajo futi marshin e mbrapsmë duke ecur ngadalë. U zgjata përpara dhe hapa radion, ndërsa Kloe ndezi një cigare tjetër në ndenjësën e pasme, duke e hedhur fijen e shkrepëses nga dritarja. Kur ishim gati të dilnim në rrugë, Xhesi bëri shenjë me kokë në drejtim të një koshi të madh metalik plehrash pranë pikës së karburantit, rreth gjashtë metra larg.

- Vëmë bast? - pyeti ajo dhe unë zgjata qafën për të vlerësuar distancën, pastaj mora kokakolën e saj thuajse të boshatisur dhe e tunda për të ndier peshën.

- Sigurisht, - i thashë. - Dy dollarë.

- Oh, Zot, - foli Kloe nga ndenjësja e pasme, duke shfryrë me zë të lartë. - Tani që nuk jemi më në shkollë të mesme, a mund t'i lëmë këto lojëra?

Xhesi e shpërfilli duke marrë kokakolën e duke e shtrënguar fort në dorën e saj. Përkuli kyçin e dorës dhe pastaj e nxori krahun nga dritarja. Picërroi sytë, ngriti mjekrën e me një lëvizje të shkëlqyer, e ngriti krahun lart

dhe e hodhi kokakolën, e cila bëri një hark sipër kokave tona dhe makinës. E pamë si u rrotullua nga njëri skaj në tjetrin, në një spirale të përsosur, para se të zhdukej me një kërcitje në koshin e plehrave, me kapakun ende aty dhe pipën të futur brenda.

- Çudi e madhe, - i thashë Xhesit. Ajo më buzëqeshi. - Kurrë nuk kam mundur ta kuptoj si e bën këtë.

- A mund të vazhdojmë tani? - pyeti Kloe.

- Si çdo gjë tjetër, - u përgjigj Xhesi, duke u futur në trafik, - sekreti është te kyçi i dorës.

“Vendi” ku gjithnjë e nisnim mbrëmjen tonë, në të vërtetë i përkiste Kloes. Prindërit e saj u divorcuan kur ajo ishte në klasën e tretë. I ati ishte larguar nga qyteti me të dashurën e tij të re, duke i shitur tërë pronat që kishte në qytet kur punonte si sipërmarrës ndërtimesh urbane. Mbajti vetëm një truall jashtë qytetit, pranë shkollës sonë të mesme, një fushë me bar, ku nuk kishte asgjë veç një trampoline që ia kishte blerë Kloes kur mbushi shtatë vjeç. Mamaja e Kloes e kishte hequr shpejt nga kopshti prapa shtëpisë, sepse nuk i shkonte me dekorin anglez, me gardhe të blerta e të gdhendura dhe stola prej guri. Kështu ajo përfundoi te trualli, e braktisur, derisa ne u rritëm, morëm patentat e kishim nevojë për një vend tonin.

Uleshim gjithnjë mbi trampolinë, e cila ishte vendosur në mes të barit, me pamjen më të mirë nga yjet dhe qielli. Ende ishte elastike për një kërcim të mirë dhe çdo lëvizje në njërin krah transmetohej edhe në krahun tjetër, saqë çdo lëvizje e papritur nga ndonjëra mund të na vinte përpara ne të tjerave. Këtë duhet ta kishim mirë parasysh sa herë që mbushnim ndonjë gotë.

- Kujdes! - i tha Kloe Xhesit, krahu i së cilës po tundej teksa po hidhte pak rum në kokakolën time. Ishte një nga ato shishet e vogla të avionit, të cilat mamaja e saj i sillte

rregullisht në shtëpi nga puna. Bufeja e tyre e pijeve dukej sikur ishte skicuar për xhuxhë.

- Oh, rehatohu! - iu përgjigj Xhesi duke kryqëzuar këmbët e duke u mbështetur prapa mbi pëllëmbët e saj.

- Kështu ndodh gjithmonë kur mungon Liza, - shfryu Kloe, teksa hapte një tjetër shishe për vete. - Balanca e peshës prishet.

- Kloe, - ia ktheva, - lëre këtë muhabet! - Piva një gllënjë nga kokakola ime tashmë me rum dhe e shijova. Pastaj ia zgjata Xhesit thjesht për mirësjellje. Ajo nuk pinte kurrë as alkool e as duhan. Gjithnjë i jepte makinës. Duke qenë një mama për vëllezërit e saj për një kohë kaq të gjatë, ishte krejt ndryshe nga ne.

- Natë e bukur, - iu drejtova dhe ajo pohoi me kokë. - Nuk mund ta besoj që gjithçka mbaroi.

- Shyqyr Zotit! - tha Kloe, duke fshirë gojën me shpinën e dorës. - Më në fund...

- Të pimë për këtë, - fola unë dhe u përkula përpara për ta përplasur gotën time me shishen e saj të vogël.

Qëndruam të ulura atje, befas të heshtura, ku nuk dëgjohej asnjë zhurmë përveç këngës së gjinkallave nëpër pemët përreth nesh.

- Është vërtet e çuditshme, - tha Kloe. - Nuk duket aspak ndryshe tani.

- Çfarë nuk duket? - e pyeta.

- Çdo gjë, - u përgjigj. - Dua të them që, mezi e kemi pritur këtë, apo jo? Shkolla e mesme mbaroi. Kjo është diçka krejtësisht e re për ne, por unë ndihem njësoj.

- Ndiheh kështu sepse asgjë e re nuk ka filluar ende, - ia ktheu Xhesi. E kishte anuar fytyrën, me sytë lart nga qielli sipër nesh. - Në fund të verës gjërat do të fillojnë të duken të reja. Sepse ashtu do të jenë.

Kloe nxori një tjetër shishe të vogël nga xhaketa, kësaj radhe xhin, dhe e hapi.

- Sa e shpifur është të presësh që të fillojë gjithçka, - tha dhe ktheu një gllënjë.

U dëgjua boria e një makine që binte me zhurmë e më pas u shua teksa makina kaloi në rrugën prapa nesh. Kjo ishte e bukura e “vendit” tonë: mund të dëgjoje çdo gjë, por askush nuk mund të të shikonte.

- Është thjesht koha e ndërmjetme, - i thashë. - Do të ikëshumë më shpejt nga sa e mendon ti.

- Shpresoj të jetë kështu, - u përgjigj Kloe, ndërsa unë u rehatova mbi bërrylat e mi, duke e përkulur kokën nga njëra anë e duke ngritur sytë nga qielli, i cili ishte ngjyrëtrëndafil, me vija të kuqe. Kjo ishte pjesa që njihnim më mirë: kalimin nga muzgu në errësirë. Dukej sikur gjithnjë e prisnim natën këtu. Ndieja trampolinën të lëvizte edhe kur merrnim frymë, teksa ngjyrat lart në qiell zbeheshin ngadalë dhe yjet nisnin të shfaqeshin.

Kur arritëm te “Bendo”, kishte vajtur ora nëntë. Parkuam makinën dhe ia ngulëm sytë rojës së klubit, i cili po qëndronte pranë derës.

- Mrekulli! - thashë duke ulur diellmbrojtësen për të kontrolluar tualetin në pasqyrë. - Është Rodni.

- Ku është karta ime e identitetit? - foli Kloe duke rrëmuar në xhaketën e saj. - O Zot, ku e lashë tani?

- Mos e ke futur te sutienat? - e pyeta, duke u kthyer. Ajo kapsiti sytë, e futi dorën poshtë këmishës dhe e gjeti. Kloe mbante gjithçka te sutienat: kartën e identitetit, pará, karfica flokësh. Nga mënyra si i nxirrte gjërat që andej, dukej sikur po bënte ndonjë numër shpejtësie, sikur po nxirrte monedha çerekdollarëshe nga veshi apo lepuj nga një kapele.

- Bingo, - u përgjigj duke e futur në xhepin e përparmë.

- Çfarë klasi! - tha Xhesi.

- Shiko kush flet! - ia ktheu Kloe. - Të paktën unë vesh sutiena.

- Të paktën mua më nevojiten, - u përgjigj Xhesi.

Kloe picërroi sytë. Ajo kishte gjoks të vogël dhe këtë e kishte pasur gjithnjë problem.

- E po, të paktën...

- Mjaft! - thirra unë. - Hajde të ikim!

Teksa po ngjismim shkallët, Rodni na i kishte ngulur sytë nga stoli ku ishte ulur pranë derës. "Bendo" ishte një klub për moshat tetëmbëdhjetë e lart, por ne kemi ardhur këtu që në vitin e dytë. Duhet të ishe njëzet e një që të merrje pije, por me karta identiteti të falsifikuara, unë dhe Kloe zakonisht nuk kishim probleme, sidomos kur ishte Rodni.

- Remi, Remi, - tha ai kur futa dorën në xhep dhe nxora kartën e identitetit të falsifikuar. Emri im, fytyra ime, ditëlindja e vëllait tim, kështu që mund t'i përsërisja në çast nëse do të më duhej ta bëja. - Si ndihesh tani që mbarove shkollën e mesme?

- Nuk e di për çfarë po flet? Buzëqesha. - Ti e di që unë jam studente në vitin e parafundit në universitet.

Ai as nuk ia hodhi sytë kartës sime të identitetit, por më shtrëngoi fort dorën, duke e prekur me gishtërinjtë e tij teksa vuri vulën. E neveritshme.

- Për çfarë studion?

- Letërsi angleze, - ia ktheva. - Por, kam marrë si lëndë plotësuese edhe biznesin.

- Kam një biznes për ty, - tha, duke marrë kartën e identitetit të Kloes. Ajo u tregua e shkathët dhe u tërhoq shpejt prapa, e llangosur me bojën e vulës.

- Ti je trap, - ia ktheu Xhesi, por ai ngriti supet duke na e bërë me dorë të hynim brenda me sytë nga grupi tjetër i vajzave që po ngjitnin shkallët.

- Jam bërë helaq, - psherëtiu Kloë kur po futeshim brenda.

- Do të ndihesh më mirë pasi të pish një birra.

“Bendo” tashmë ishte mbushur plot. Grupi nuk kishte ardhur akoma, por bari ishte shumë i gjatë dhe ajri ishte rënduar nga tymi i duhanit i përzier me erën e djersës.

- Po zë një tavolinë, - thirri Xhesi dhe unë pohova me kokë, duke u drejtuar për nga bari me Kloën prapa meje. Çamë përmes turmës, duke iu shmangur njerëzve, derisa gjetëm një vend të përshtatshëm pranë fuçive të birrës.

Isha ngritur lart e mbështetur mbi bërryla e po përpiqesha t’ia bëja me dorë baristit, kur ndjeva dikë pranë meje. U përpoqa të largohesha, por ai ishte ngjeshur aty ku po qëndroja unë, kështu që u tërhoqa pak nga brenda, duke i nxjerrë krahët anash. Pastaj, ndjeva të më fliste në vesh me zë të ulët.

- Ja ku u takuam sërish, - e tha këtë në një mënyrë të çuditshme, tamam si në romanet e mamit tim.

Ktheva kokën fare pak dhe, mu atje, gati sipër meje ishte djali që takova te biznesi i makinave. Kishte veshur një bluzë të kuqe që i bënte reklamë një detergjenti dhe më buzëqeshte.

- Oh, Zot, - thashë.

- Jo, jam Deksteri, - u përgjigj, duke më zgjatur dorën, të cilën e shpërfilla. U ktheva pas dhe hodha një shikim përreth për Kloën, por pashë që e kishte ndalur një djalë me këmishë me kutia që nuk e njihja.

- Dy birra, - i thirra baristit, që më në fund më pa.

- Bëji tri, - bërtiti Deksteri.

- Ti nuk je me mua, - ia ktheva.

- Në fakt, jo, - u përgjigj duke mbledhur supet. - Por kjo mund të ndryshojë.

- Dëgjjo, - i thashë kur baristi la tri gota plastike përpara meje, - unë nuk jam...

- Me sa po shoh, e paske ende numrin tim, - më ndërpreu dhe rrëmbeu njëren nga birrat. Përplasi gjithashtu dhjetë dollarë mbi banak, duke e kompensuar disi budallallëkun që bëri.

- Nuk pata mundësi ta pastroja.

- A do të të bënte përshtypje po të thosha që jam në një grup muzikantësh?

- Jo

- Fare? - pyeti duke ngritur vetullat. - O Zot, mendoja se zogëzat i adhurojnë djemtë e grupeve.

- Së pari, nuk jam zogëz, - i thashë duke rrëmbyer birrën time. - Dhe së dyti, kam një rregull për muzikantët, të cilin nuk e thyej kurrë.

- Që është?

I ktheva shpinën dhe nisa të çaj me bërryla përmes turmës për të shkuar te Kloe.

- Nuk ngatërrohem me muzikantë.

- Unë mund të bëj një këngë për ty, - më propozoi duke më ndjekur nga pas. Po ecja aq shpejt, sa që birrat që po mbaja filluan të derdheshin.

- Nuk dua këngë.

- E kujt nuk do i pëlqente një këngë?

- Mua. - I rashë lehtë Kloes në sup dhe ajo u kthye. Kishte marrë atë pamjen flirtuese në fytyrë, me sy të zgurdulluar dhe e kuqe flakë. I zgjata një birrë dhe i thashë: - Po shkoj të gjej Xhesin.

- Po vij edhe unë, - u përgjigj duke tundur gishtat e dorës teksa përshëndeste djalin me të cilin kishte biseduar. Ndërsa

“muzikanti i çmendur” vazhdonte të më vinte nga pas ende duke folur.

- Mendoj që ti më pëlqen, - më tha teksa i shkela këmbën duke i shkaktuar një angullimë. Vazhdova rrugën.

- Mendim i gabuar, - iu përgjigja më në fund, duke parë Xhesin në një kabinë telefonike në qoshe të rrugës, me kokën të mbështetur mbi njërin bërryl. Dukej e mërzitur. Kur më pa, ngriti lart të dyja duart, duke nënkuptuar “Çfarë dreqin do ai?” me gjestin e saj. Unë, thjesht, tunda kokën.

- Kush është ai djali? - thirri Kloe prapa meje.

- Askushi, - i thashë.

- Dekster, - u përgjigj ai, duke u kthyer paksa për t’i dhënë dorën, megjithëse ende vazhdonte të ecte me një hap me mua. - Si je?

- Mirë, - ia ktheu ajo si me bezdi. - Remi?

- Vazhdo rrugën! - i thirra, duke kaluar pranë dy djemve me gërsheta të hollë. - Do ta humbë interesin së shpejti.

- Oh, nuk besoj, - u përgjigj me ngazëllim. - Ky është vetëm fillimi.

Arritëm te tavolina që të tre: unë, Kloe dhe Dekster muzikanti. Unë isha duke gulçuar, ajo e hutuar ndërsa ai thjesht u ul pa u ndier afër Xhesit duke i zgjatur dorën.

- Ç’kemi? - i tha. - Unë jam me këto.

Xhesi më vështroi, por unë isha shumë e lodhur për të reaguar. U dystova në tavolinë dhe piva një gllënjë birrë.

- Edhe unë, me këto jam, - ia ktheu ajo, - por nuk jam me ty. Si është e mundur kjo?

- Në fakt, - u përgjigj ai, - është një histori interesante.

Askush nuk foli për një minutë. Më në fund, rënkova dhe thashë:

- Oh, Zot dhe ju goca! Tani do t’jua tregojë.

- Isha te koncesionari i makinave sot, - filloi ai duke u mbështetur te stoli, - dhe pashë një vajzë. Ishte si në ato rastet kur dallon dikë në një dhomë plot me njerëz. Një moment i vërtetë, më kuptoni?

Rrotullova sytë. Kloe pyeti:

- Dhe kjo vajza duhet të ishte Remi?

- E saktë. Remi, - u përgjigj duke përsëritur emrin tim me një buzëqeshje. Pastaj sikur të ishim dy të sapomartuar të lumtur që po ua tregonim historinë tonë të panjohurve, shtoi:

- Ke qejf ta vazhdosh ti pjesën tjetër?

- Jo, - i thashë prerë.

- Atëherë, - vazhdoi duke i rënë me pëllëmbë tavolinës për t'i dhënë rëndësi asaj që do të thoshte, duke bërë që të gjitha gotat tona të tundeshin. - E vërteta është se unë jam njeri impulsiv. Njeri që veproj. Kështu, iu afrova dhe iu prezantova.

Kloe vështroi nga unë duke buzëqeshur.

- Vërtet? - tha.

- A mund të ikësh tani? - e pyeta sapo muzika mbi kokën tonë u ndal befaz dhe u dëgjua një trokitje e lehtë nga skena, e pasuar nga një zë që po provonte mikrofonin: “*Një, dy, tre*”.

- Detyra po më thërret, - ma ktheu duke u ngritur. Gotën e tij të papërfunduar të birrës e vendosi pranë meje dhe më tha: - Do shihemi më vonë?

- Jo.

- Mirë, atëherë! Do flasim më vonë. Pastaj u përzje me turmën dhe u largua. Qëndruam ashtu të ulura atje për një sekondë. Përfundova birrën, pastaj mbylla sytë dhe ngrita gotën duke e shtrënguar te tëmthi. Si mund të isha që tani kaq e rraskapitur?

- Remi, - foli më në fund Kloe, e mprehtë si gjithmonë.

- Po na mban sekrete.

- Jo, nuk është e vërtetë, - iu përgjigja. - Ishte thjesht një budallallëk që më kishte dalë fare nga mendja.

- Sa shumë që fliste! - komentoi Xhesi.

- Kurse mua më pëlqeu këmisha e tij, - ia ktheu Kloe. - Qenka modern.

Pikërisht në këtë çast Xhonatani u ul pranë meje pa u ndier.

- Si po kaloni zonjusha? - pyeti teksa rrëshqiti krahun rreth belit tim. Pastaj, mori birrën e “*muzikantit të çmendur*”, duke menduar se ishte e imja dhe piu një gllënjë të madhe. Do ta kisha ndaluar, por thjesht fakti që veproi ashtu ishte pjesë e problemit tonë. E kisha zët kur djemtë më trajtonin si pronë të tyre dhe Xhonatani ishte sjellë kështu që në fillim të lidhjes sonë. Ishte më i madh se unë, djalë i këndshëm, por sapo nisëm të dilnim bashkë donte që ta merrnin vesh të gjithë dhe ngadalë filloi të cenonte territorin tim. Pinte cigaret e mia, që m’i merrte nga dora ndërkohë që po i pija vetë. Përdorte gjatë tërë kohës celularin tim për të bërë telefonata, pa më pyetur fare, ndërsa kulmi ishte kur rehatohej më shumë se ç’duhej në makinën time. Nuk lejoja askënd të ndryshonte as stacionet që kisha regjistruar vetë apo të rrëmonte në tavllën me monedha, por Xhonatani shkonte përtej kësaj dhe ngulte këmbë që t’i jepte makinës, megjithëse e kaluara e tij tregonte se rreshti i faturave të dëmtimeve të makinës dhe e gjobave për tejkalim të shpejtësisë ishte i gjatë sa krahu im. Idiotësia ime më e madhe ishte se e lejoja, ndoshta e dehur siç isha nga dashuria (kurrsesi) apo epshi (kishte shumë të ngjarë) dhe pastaj, ai priste që unë të udhëtoja si pasagjere në makinën time, përgjithmonë. Tashmë nga sjellja i përngjante Kenit,

“të dashurit ekstremist”, që gjithnjë m’i rrëmbente gjërat në publik ose e pinte pa më pyetur atë që mendonte se ishte birra ime.

- Duhet të kaloj një sekondë nga shtëpia, - tha i përkulur pranë veshit tim. E hoqi dorën nga beli im dhe ma vuri te gjuri. - A po vjen me mua?

Pohova me kokë, ndërsa ai përfundoi birrën, duke e përplasur gotën mbi tavolinë. Xhonatani pinte shumë nëpër festa, një tjetër problem ky që më shqetësonte. Edhe unë pija. Por ai e katranoste fare. Përfundonte me të vjella. Në gjashtë muajt që kemi qenë bashkë, kur shkonim nëpër festa, e kaloja një pjesë të mirë të kohës te dera e banjës duke e pritur të mbaronte të vjellat që të shkonim në shtëpi. Kjo ishte vërtet e pakëndshme.

U ngrit ngadalë duke e hequr dorën nga gjuri im e duke më kapur për dore.

- Do të kthehem prapë, - i thashë Xhesit dhe Kloes. Dikush na u fut në mes dhe më në fund Xhonatani dhe unë u shkëputëm nga njëri-tjetri duke u ngatërruar me turmën.

- Paç fat! - u përgjigj Kloe. - Nuk e besoj dot që e le të pinte birrën e atij djalit.

U ktheva dhe pashë Xhonatanin që po më shikonte me padurim.

- Ta dijë ai se ç’ë pret... - tha Xhesi me zë të ulët, ndërsa Kloe turfulloi.

- Mirupafshim! - ia ktheva dhe çava përmes turmës ku dora e Xhonatanit ishte zgjatur duke pritur që të më kapte sërish.

- Duhet të flasim! - i thashë duke e shtyrë prapa.

- Tani?

- Tani.

Psherëtiu, pastaj u rehatua mbi shtrat duke e mbështetur kokën në mur.

- Atëherë, po të dëgjoj.

I vura gjunjët mbi shtrat, pastaj rregullova bluzën pa mëngë që kisha veshur. “Do të kaloj nga shtëpia për diçka” kishte ndryshuar shumë shpejt në “Do të bëj disa telefonata” dhe më pas ai ishte i tëri sipër meje, duke më shtyrë prapa te jastëkët. Por, tani, kisha tërë vëmendjen e tij.

- Puna është se gjërat po fillojnë vërtet të ndryshojnë për mua tani.

Kjo ishte fjalja hyrëse. Gjatë viteve kisha mësuar se kishte një sërë teknikash që mund të përdroreshin kur doje t’i jepje fund lidhjes me dikë. Disa djem indinjoheshin dhe mërziteshin keq, disa ankoheshin dhe qanin, ndërsa disa të tjerë silleshin si indiferentë dhe të ftohtë, duke nënkuptuar se mund të isha larguar edhe më shpejt. Xhonatani më dukej se i përkiste grupit të fundit, por nuk isha plotësisht e sigurt.

- Sidoqoftë, - vazhdova, - kam menduar që...

Në këtë çast ra telefoni dhe e humba sërish momentin tim. Xhonatani e rrëmbeu.

- Alo? - Pastaj u dëgjuan pak “hëm-hëmm”, nja dy “poo” dhe ai u ngrit në këmbë. Eci nëpër dhomë dhe u fut në banjë, akoma duke murmuritur.

Kalova gishtat nëpër flokë dhe më vinte inat që nuk po e gjeja dot kohën e përshtatshme. E dëgjoja ende të fliste, mbylla sytë dhe shtriva krahët sipër kokës, ndërsa gishtërinjtë prekën anën e dyshekut afër murit. Ndjeva diçka.

Kur Xhonatani, më në fund, e mbylli telefonin, i hodhi një sy vetes në pasqyrë dhe u kthye në dhomën e gjumit. Unë isha ulur atje, këmbëkryq, me një palë mbathje të kuqe femrash, të hedhura mbi krevat mu përpara meje. (I kisha kapur me një pecetë letre *Kleenex*). Ai hyri në dhomë, tërë vetëbesim dhe sapo i pa u ndal në vend i tronditur.

- Hëm, - murmuriti, teksa mori frymë thellë, i habitur.
Pastaj e mblodhi veten shpejt. - Hej, hëm, çfarë...

- Çfarë dreqin janë këto?

- Nuk janë të tuat?

Ngrita sytë në tavan duke tundur kokën. E si mund të vishja unë mbathje të lira prej poliestre të kuqe! Nuk isha e këtij niveli, apo jo? Pa shiko, me kë i kisha çuar dëm gjashtë muajt e fundit!

- Sa kohë? - e pyeta.

- Çfarë?

- Sa kohë ke që shkon me dikë tjetër?

- Nuk ishte...

- Sa kohë? - përsërita me egërsi.

- Unë nuk...

- Sa kohë?

U gëlltit dhe për një sekondë ky ishte i vetmi tingull në dhomë. Pastaj tha:

- Nja dy javë.

U ula duke shtrënguar tëmthat me gishtërinj. O Zot, kjo ishte hataja vetë. Tani, jo vetëm që më kishte mashtruar, por do ta merrnin vesh të gjithë dhe do të ndihesha si viktimë, gjë të cilën e urreja më shumë se gjithçka. E shkreta, e shkreta Remi... Doja ta vrisja.

- Ti je trap, - i thashë. Ishte skuqur i tëri dhe po dridhej. Aty kuptova se ai mund t'i përkiste grupit të djemve qaramanë, nëse gjërat do të kishin shkuar ndryshe. E habitshme! Kurrë nuk i dihet...

- Remi. Më lër të...

Zgjati dorën dhe më preku krahun. Për të parën herë isha në gjendje të bëja atë që doja. E tërhoqa fort krahun sikur të më kishte djegur.

- Mos më prek! - bërtita. Rrëmbeva pulovrin tim, duke e lidhur rreth belit dhe u drejtova për nga dera, duke e

dëgjuar të pengohet pas meje. Nuk lashë dorë të shtëpisë pa e përplasur dhe mbërrita te rrugina e përparme me një vrull të madh. Vetëm kur u gjenda përpara kutisë postare i thirra mendjes. E ndieja që po më shikonte nga shkallët përpara shtëpisë, teksa largohesha. Nuk thirri dhe nuk tha asgjë. Jo se po vdisja që ta bënte, sepse kjo nuk do të ndryshonte asgjë. Por shumica e djemve do të ishin treguar, të paktën, të sjellshëm dhe do të ishin përpjekur.

Po ecja nëpër lagje në mes të natës, shumë e mërzitur e pa makinë. Ishte e premte. E para e premte mbrëma për mua si e rritur. Kisha mbaruar shkollën e mesme dhe tashmë isha në *“Botën e Vërtetë”*. *“Mirëserdhe”*, thashë me vete.

- Ku dreqin ishe? - më pyeti Kloe kur mbërrita më në fund te *“Bendo”* me ndihmën e transportit publik, rreth njëzet minuta më vonë.

- Nuk do e besoni dot... - fillova.

- Jo tani! - Më kapi për krahu, duke më tërhequr përmes turmës e duke më nxjerrë jashtë. Pashë Xhesin në makinën e saj. Dera e shoferit ishte e hapur. - Ka ndodhur diçka.

Kur iu afrova makinës, në fillim nuk e pashë Lizën. E ulur në ndenjësën e pasme dukej e katranosur fare teksa shtrëngonte një tufë nga ata peshqirët ngjyrëkafe prej letre, që gjenden në banjat e shkollave apo restoranteve. Fytyra i ishte skuqur dhe lotët i binin çurg. Po qante me ngashërim.

- Çfarë dreqin ndodhi? - e pyeta duke e hapur me forcë derën e prapme dhe duke u ulur pa u ndier pranë saj.

- Adami u n-n-nda nga unë, - foli me zërin që i dridhej.
- Më la.

- O Zot! - thashë teksa Kloe hipi përpara duke përplasur derën. Xhesi tashmë e kthyer me fytyrë nga ne më pa mua dhe tundi kokën.

- Kur?

Liza mori frymë thellë dhe shpërtheu sërish në lot.

- Nuk mundem, - murmuriti duke fshirë fytyrën me një peshqir letre. - Nuk mundem as të...

- Sonte, kur shkoi ta merrte nga puna, - më shpjegoi Kloe. - E çoi në shtëpinë e tij që të bënte një dush dhe ia tha atje. As paralajmërim. Asgjë.

- Aty ishin edhe prindërit e tij, - shtoi Liza duke tërhequr hundët. - Edhe ata e dinin. Më vështruan si të isha një qen i rrahur.

- Po ai çfarë tha?

- I tha se kishte nevojë të shijonte lirinë e tij, - u përgjigj Kloe, në rolin e zëdhënëses së saj. - Meqenëse ishte verë dhe shkolla e mesme kishte mbaruar, nuk donte që asnjëri prej tyre të humbiste mundësitë që do t'i krijoheshin në universitet. Ai donte të sigurohej që...

- Ta j-j-jetojmë jetën në maksimum, - e përfundoi Liza duke fshirë sytë.

- Trap, - shfryu Xhesi. - Më mirë që ndodhi tani.

- Unë e d-d-dua! - rënkoj Liza, teksa u zgjata duke i hedhur krahun në sup.

- Mos u mërzit! - i thashë.

- Dhe unë as që ia kisha idenë, - foli duke marrë frymë thellë dhe e nxori e tronditur, duke u dridhur, teksa e vuri mënjanë peshqirin prej letre që mbante në dorë, duke e lënë të bjerë përdhe. - Si nuk e kisha kuptuar?

- Liza, do të të kalojë, - i tha Kloe, me zërin e saj të butë.

- Më duket vetja si Xhonatani, - tha duke qarë me ngashërim e duke u mbështetur tek unë. - Ne po jetonim jetët tona, po merrnim rrobat në pastrimin kimik...

- Çfarë? - pyeti Xhesi.

- ... pa e ditur, - vazhdoi Liza, - që sonte do të na braktisnin.

- Meqë ra fjala, - Kloe u drejtua nga unë, - si shkoi?

- Mos më pyet! - ia ktheva.

Liza tani po qante me dënësë me fytyrën e fshehur në supin tim. Sipër kokës së Kloes shihja “Bendon” që ishte mbushur plot dhe radha vazhdonte jashtë derës.

- Hajdeni të ikim! - i thashë Xhesit dhe ajo miratoi me kokë. - Kjo mbrëmje na u shpif gjithsesi.

Kloe u lëshua në ndenjësen e përparme të pasagjerit, duke shtypur ndezësin e cigares, ndërsa Xhesi ndezi makinën. Liza shfryu hundët në peshqirin prej letre që i dhashë unë, pastaj vazhdoi me ngashërime të vogla e të shpejta, duke u rehatuar pranë meje. Kur u nisëm, i ledhatova kokën, sepse e dija sa e lënduar ishte. Nuk ka më keq se kur kjo ndodh për herë të parë.

Natyrisht, na u desh një tjetër raund me pijet tona që i blinim te “Zip”. Pastaj Kloe iku, ndërsa Xhesi u nis të na çonte mua dhe Lizën në shtëpinë time.

Ishim thujse te degëzimi që të çonte te lagjja ime, kur Xhesi befas ngadalësoi shpejtësinë dhe më tha me zë shumë të ulët:

- Qenka Adami këtu.

U ktheva majtas. Vërtet, Adami me shokët e tij po qëndronin te parkingu përpara një kafeneje. Në fakt, u mërzita kur e pashë duke buzëqeshur. Trapi.

Hodha një vështrim të shpejtë pas vetes, por Liza i kishte sytë të mbyllur. Ishte shtrirë në ndenjësen e prapme dhe po dëgjonte radion.

- Ndalo! - i thashë Xhesit. U ktheva prapa. - Hej, Liz?

- Hëm, - u përgjigj ajo.

- Mos lëviz, mirë? Qëndro ashtu shtrirë!
- Në rregull, - ma ktheu me ngurrim.
- Makina uturiu, teksa Xhesi më pyeti:
- Ti apo unë?
- Unë, - i thashë duke pirë edhe një gllënjë nga pija ime.
- E kam të nevojshme ta bëj këtë sonte.
- Xhesi i dha pak më tepër gaz.
- Gati?

Tunda kokën, teksa kokakola ime dietetike *Zip* ishte balancuar në dorën time, në mënyrë të përsosur.

Xhesi i dha shumë gaz dhe u larguam si shigjetë. Gota u rrotullua skaj më skaj në ajër e dukej pa peshë. E goditi Adamin mu prapa kokës dhe kokakola dietetike me akulliu derdh si një dallgë mbi shpinë. Nuk ishte gjuajtja ime më e mirë, por as keq nuk ishte. Kur ai na pa, qe tepër vonë.

- Ta hajë dreqi! - ulëriti prapa nesh. - Liza! Në djall shkofsh! Remi! Je një kuçkë!

Ai ende po çirrej kur e humba nga sytë.

Pasi hëngrëm pa fund biskota me çokolletë të mbushura me krem të bardhë, pimë katër cigare dhe harxhuam një mal me shami letre *Kleenex*, më në fund Liza u bind të flinte. E zuri gjumi në çast. Merrte frymë me hundë, ndërsa jorgani im i ishte ngatërruar nëpër këmbë.

Mora një batanije e një jastëk. Vajta afër dollapit dhe u shtriva mbi dysheme. Arrija ta shihja nga aty dhe u sigurova që vazhdonte të flinte top. Pastaj, shtyva mënjanë kopicën me kuti këpucësh që i mbaja në qoshen e djathtë më të largët dhe nxora diçka që e kisha fshehur atje.

Kisha kaluar një mbrëmje kaq të keqe. Nuk e bëja vazhdimisht këtë, por ndonjë natë e kisha të nevojshme. Askush nuk e dinte.

U rehatova duke u mbuluar me batanije, hapa peshqirin e palosur e nxora që andej një magnetofon të vogël dhe kufjet. Pastaj i vura në vesh, fika dritën dhe shtypa këngën me numër shtatë. Kisha një dritare të vogël në tavanin e pjerrët dhe nëse shtrihesha në të djathtë, drita e hënës binte direkt mbi mua. Nganjëherë mund të shihja edhe yjet.

Kënga nisi ngadalë. Dëgjoheshin vetëm pak tela të kitarës. Pastaj një zë, që e njihja aq mirë. Fjalët i dija përmendsh. Ishin disi të rëndësishme për mua. Askush nuk kishte pse ta merrte vesh. Por ato kishin vërtet rëndësi.

*Kjo ninullë ka shumë pak fjalë
që shoqërojnë tingujt në kitarë
me zë të ulët, në këtë dhomë bosh
por ti mund ta dëgjosh, ta dëgjosh,
kudo që do të shkosh
e zhgënjyer nga unë do të jesh,
por këtë ninullë sërish do ta dëgjosh...*

Më zinte gjumi me të, me zërin e tij... Gjithmonë ndodhte kështu... Sa herë e dëgjoja...

Kreu i tretë

- Uuuuuuuuuuu!

- Sa më dhemb!

- Oh, moj vajzëëëë!

Në sallën e pritjes dy zonja që po prisnin radhën për manikyr panë njëra-tjetrën e pastaj mua.

- Depilim bikini, - shpjegova.

- Oh, - tha njëra prej tyre dhe iu kthye revistës së saj.

Tjetra vazhdonte të qëndronte e ulur atje, me veshët përpjetë si qen gjahu, në pritje të britmës tjetër. Nuk kaloi shumë dhe znj. Maikëll e lëshoi:

- Ouuuuu, sa e tmerrshmeeee! - Znj. Majkëll mezi po e përballonte depilimin në takimin e këtij muaji. Ishte gruaja e një prej klerikëve të qytetit dhe e donte Zotin po aq shumë sa donte edhe një trup të lëmuar e pa qime. Gjatë vitit që kisha punuar në sallonin “Xhoi”, kisha dëgjuar më tepër të shara nga dhoma e pasme ku Telinga merrej me depilime, sesa nga të tëra dhomat e tjera të marra së bashku. Këtu përfshiheshin puna e dobët me manikyrët, prerjet shkel e shko të flokëve apo shqetësimi i grave pas një maske trupi me alga, me të cilën u dukej sikur e kishin lyer trupin me gëlqere.

Jo se “Xhoi” ishte vend i keq. Por ishte e pamundur t’i kënaqje të gjithë, sidomos gratë, kur bëhej fjalë për pamjen e tyre të jashtme. Për këtë arsye, Lola, pronarja e “Xhoit”, sapo më kishte bërë një ngritje page, me shpresën se ndoshta do t’i ktheja shpinën Stenfordit e do të qëndroja në sallën e saj të pritjes përgjithmonë, për t’i mbajtur njerëzit nën kontroll.

E kisha nisur këtë punë sepse më duhej një makinë. Mami donte të më jepte makinën e saj, një *Camry* të këndshme e të merrte për vete një të re, por ishte e rëndësishme për mua ta blija vetë. E doja mamanë time, por kisha mësuar prej shumë kohësh të mos bëja më marrëveshje më të, përveç rasteve kur kjo ishte e detyrueshme. Tekat e saj ishin të famshme dhe mund të ndodhte që një ditë të bukur të ma merrte makinën, vetëm sepse i ishte mbushur mendja se e reja nuk i pëlqente më.

Kështu e boshatisa llogarinë time të kursimeve, ku kisha futur kryesisht paratë e fituara si dado fëmijësh apo gjatë Krishtlindjeve e që i kisha ruajtur mënjanë për vite me radhë. Lexova për vlerësimet dhe përshtypjet e konsumatorit si dhe bëra sa munda kërkime lidhur me modelet e reja, para se të shkoja të blija makinën. U grinda, diskutova, blofova, durova kaq shumë gjepura të shitësve, sa thashë se vdiqa. Por, më në fund, bleva makinën që doja, një *Honda Civic* të re, me çdo gjë automatike e me një çmim shumë larg shumë të desh më zhvati pronari. Ditën që e mora vajta drejt e te “Xhoi” dhe plotësova një formular, sepse para një jave kisha parë një tabelë në dritaren e tyre të përparme: “KËRKOHET NJË RECEPSIONISTE”. Pra, sigurova pagesën e makinës dhe një punë para se të fillonte viti i fundit i shkollës së mesme.

Telefoni po binte kur znj. Majkëll doli nga dhoma e depilimit. Në fillim trembesha kur i shihja sa keq dukeshin

femrat menjëherë pasi dilnin nga ajo dhomë: sikur ishin kthyer nga lufta apo si viktima të një zjarri. Ajo ecte si e ngrirë dhe iu afrua tryezës sime. Depilimi i bikinit ishte vërtet i tmerrshëm.

- Salloni “Xhoi”, - u përgjigja në telefon. - Unë jam Remi.

- Alo, Remi, jam Loren Beikër, - tha me nxitim gruaja në anën tjetër të linjës. Znj. Beiker fliste gjithnjë me zë të mekur e duke gulçuar. - Oh, duhet të më gjesh një orar për manikyr sot. Karli ka ftuar një klient të rëndësishëm dhe do të shkojmë te restoranti “La Corolla”. Por këtë javë çmontova tavolinën e mesit dhe duart e mia janë bërë...

- Një sekondë ju lutem, - u përgjigja prerë, me zërin tim “*tepër profesional*” dhe shtypa butonin “*qëndroni në linjë*”. Znj. Majkëll u ngërdhesh teksa nxori kuletën dhe lëshoi përpara meje një kartë krediti ngjyrë ari. - Shtatëdhjetë e tetë, zonjë.

Ajo miratoi me kokë, ndërsa unë kalova kartën në makinë dhe ia ktheva sërish. Fytyrën e kishte shumë të kuqe dhe pjesën rreth vetullave pothuaj plagë. Firmosi e pastaj vështroi veten në pasqyrën prapa meje, duke varur turinjte.

- Oh, Zot, - tha. - E si mund të shkoj në postë kështu?

- Ç’janë këto që thoni?! - tha Talinga, vajza që merrej me depilimin, teksa hyri si era gjoja për punë, por në të vërtetë për t’u siguruar që bakshishi i znj. Majkëll ishte i mirë e u fut në zarfin e saj. - As nuk do ta vërë re njeri. Shihemi muajin tjetër!

Znj. Majkëll e përshëndeti me dorë duke tundur gishtat, pastaj u largua. Kur ajo mbërriti te trotuari, Talinga rrëmbeu zarfin, kontrollloi kartëmonedhat e futura aty dhe lëshoi e pakënaqur një “phu”. Pastaj u ul në karrige dhe vuri njërën këmbë përmbi tjetrën, në pritje të klientes që kishte radhën.

Shtypa butonin për linjën numër një. Dëgjoja znj. Bejker të gulçonte, ndonëse nuk kisha nisur ende të flisja.

- Atëherë, kam gjetur një hapësirë për ju në tre e gjysmë, por duhet të vini në kohë, sepse Amanda pret një kliente tjetër në katër fiks.

- Tre e gjysmë? - pyeti znj. Bejker. - Në fakt, pak më herët, do të ishte më mirë, sepse kam një...

- Tre e gjysmë, - përsërita shkurt. - Është e vetmja mundësi.

Ngurroi për pak çaste, teksa frymëmarrja ishte ende shqetësuese. Pastaj tha:

- Do të vij.

- Në rregull. Do të shihemi atëherë!

Kur mbylla telefonin dhe shënova orarin e saj, Talinga më vështrroi e më tha:

- Remi, moj vajzë, sa e rreptë je!

Ngrita supet. E vërteta ishte se dija të merresha vesh me gra të tilla. Shumica e tyre ishin mësuar të kishin gjithçka. Tamam si mamaja ime... Tashmë e njihja mirë këtë lloj mentaliteti “*unë-unë-unë*”. Ato dëshironin të thyenin rregullat, të përfitonin shërbime falas, të merrnin oraret e klienteve të tjera e përsëri të pëlqeheshin “*shumë*” nga të gjithë. Kështu, e qaja këtë punë, sepse kisha eksperiencën e një jete të tërë.

Në orën që pasoi u mbusha mendjen dy grave të prisnin për manikyr. Porosita drekën për Lolën dhe nxora faturat e pagesave të një dite më parë. Në pushimin ndërmjet dy depilimeve të vetullave dhe një depilimi sqetullash, Talinga më tregoi çdo detaj rrëqethës për takimin e saj të fundit katastrofik me dikë që nuk e njihje. Por, aty nga ora dy, ritmi i punës ra disi dhe unë qëndrova e ulur

në tryezën time duke pirë një kokakola dietetike e duke vështruar e përhumbar nga parkingu.

“Xhoi” ndodhej në një qendër tregtare tejet të frekuentuar. Ishte e tëra prej betoni, mu në rrugë kryesore, por kishte disa pemë dhe një shatërvan që krijonin një peizazh të bukur. Në të djathtë tonë ishte marketi “Mayor’s”, që shiste ushqim të shtrenjtë organik. Kishte gjithashtu një kafene “Jump Java”, një videotekë, një bankë dhe një studio fotografike ku fotografitë bëheshin gati për një orë”.

Teksa shikoja ngultas jashtë, dallova një furgon të bardhë, të mbaruar fare, që parkoi pranë dyqanit që shiste ushqim për zogj. Dyert e përparme dhe anësore të furgonit u hapën dhe që andej zbritën tre djem që kishin pothuajse moshën time, të veshur me këmisha, kravatë dhe xhinse. U mblodhën për një sekondë për të diskutuar diçka e pastaj u shpërndanë, secili duke iu drejtuar një dyqani të ndryshëm. Një djalë i shkurtër me flokë të kuq kaçurrelë erdhi drejt nesh duke futur këmishën brenda pantallonave teksa po afrohej.

- Oh, Zot! - thashë. - Ja ku na erdhën edhe mormonët. - Megjithëse kishim vënë një tabelë shumë të këndshme te dritarja ku shkruhej “*JU LUTEMI, MOS NA BEZDISNI*”, më duhej gjithnjë të dëboja njerëz që shisnin bonbone apo Bibla. Piva një gllënjë nga kokakola ime dietetike, duke u bërë gati për t’iu përgjigjur kur tingëlloi zilja e derës dhe ai hyri brenda.

- Përsëndetje, - tha duke m’u afruar. Ishte i mbushur me quka, ashtu si shumë djem flokëkuq, por kishte sy të bukur me ngjyrë jeshile të errët dhe një buzëqeshje të ëmbël. Këmisha e tij, pas një vëzhgimi më të kujdesshëm, kishte një njollë te xhepi dhe ishte blerë pa dyshim në një dyqan të lirë. Kjo dukej qartë.

- Përshëndetje, - iu përgjigja. - Si mund t'ju ndihmoj?

- Doja të dija nëse keni ndonjë vend të lirë pune?

E vështrova. Te "Xhoi" nuk punonte asnjë mashkull. Jo se bëhej me dashje nga Lola, por thjesht sepse puna nuk ishte e përshtatshme për burra. Kishim një stilist mashkull, Erikun, por ai na braktisi nga fillimi i vitit për sallonin "Perëndimi i Diellit" që ishte rivali ynë kryesor, duke marrë me vete edhe një nga manikyristet tona më të mira. Që atëherë në sallon punojnë vetëm femra.

- Jo, - iu përgjigja. - Nuk kemi.

- Jeni e sigurt?

- Shumë e sigurt.

Nuk dukej i bindur, por ende vazhdonte të buzëqeshte.

- Doja t'ju pyesja, - tha djaloshi tepër simpatik, - nëse do të ishte e mundur të plotësoja një kërkesë në rast se hapet ndonjë vend pune?

- Patjetër, - ia ktheva duke hapur sirtarin e fundit të tryezës, ku mbanim bllokun me kërkesa. Ia zgjata një të bashkë me një stilolaps.

- Faleminderit shumë, - tha duke u ulur te qoshja pranë dritares. Po e shikoja nga aty ku isha, teksa shkroi me kujdes me shkronja të mëdha shtypi emrin e tij në krye të kërkesës e pastaj rrudhi ballin, duke menduar pyetjet.

- Remi, - thirri Lola duke u futur në sallën e pritjes, - a erdhi porosia?

- Akoma jo, - iu përgjigja.

Lola ishte një grua trupmadhe, që vishte rroba të ngushta e me ngjyra të ndezura. Kishte një të qeshur të fortë që i përshtatej trupit të saj të stërmadh dhe kishte ngjallur një lloj respekti e frike te klientet. Kushdo që vinte për të prerë apo krehur flokët, nuk guxonte të hynte me ndonjë fotografi

apo çfarëdo qoftë; thjesht linte atë të vendoste. I hodhi një sy djaloshit të ulur te qoshja.

- Përse ke ardhur? - e pyeti.

Ai ngriti sytë jo aq i trembur. Kjo ishte për t'u admiruar.

- Po plotësoj një kërkesë për punë, - iu përgjigj.

Ajo e mati me sy nga koka te këmbët.

- Paske vënë kravatë?

- Po, zonjë, - tha, duke tundur kokën.

Lola vështroi nga unë, pastaj sërish atë dhe ia plasi të qeshurit.

- Oh, Zot, pa shikoje këtë djalosh! Pra, ti do të punosh për mua?

- Po, zonjë, sigurisht që dua. - Ishte aq i edukuar, sa që po fitonte pikë shumë shpejt. Lola i vlerësonte ata që e respektonin.

- Di të bësh manikyr?

Ai u mendua një çast.

- Jo. Por i mësoj shpejt gjërat.

- Ditë bësh depilim bikini?

- Jo.

- Po prerje flokësh?

- Jo, natyrisht që jo.

Tundi kokën duke i buzëqeshur.

- Zemër, - tha më në fund, - je i padobishëm.

Ai miratoi me kokë.

- Mami ma ka thënë gjithmonë këtë, - ia ktheu. - Por, jam në një grup muzikor me disa djem të tjerë dhe secili nga ne duhet të gjejë një punë sot, kështu që jam gati të provoj gjithçka.

U dëgjua sërish e qeshura e Lolës. Kësaj here u duk sikur i gulfoi nga stomaku.

- Je në grup muzikor?

- Po, zonjë. Sapo kemi ardhur nga Virxhinia për muajt e verës. Dhe na duhet të gjithëve të gjejmë punë, prandaj erdhëm këtu dhe u shpërndamë.

“Pra, nuk qenkan mormonë”, mendova. “Janë muzikantë. Më keq akoma”.

- Cilën vegël muzikore luan? - pyeti Lola.

- Jam baterist, - u përgjigj.

- Si Ringo?

- Tamam.

I shkoi buza vesh më vesh dhe shtoi me zë më të ulët:

- Djalin flokëkuq e vënë gjithnjë në fund. Ndryshe të gjitha vajzat do të më suleshin mua.

Lola ia plasi gazit, aq fort sa Talinga dhe një nga manikyristet, Amanda, zgjatën kokat nga qoshja e sallës.

- Çfarë drejtin po ndodh aty? - foli Amanda.

-Për atë Zot, kravatë ka vënë ai? - pyeti Talinga.

-Shiko! - tha Lola tek përpiqej të normalizonte frymëmarrjen. - Nuk kemi asgjë për ty këtu. Hajde të shkojmë te kafeneja këtu afër dhe do të të gjej një punë. I kam bërë një nder asaj vajzës së lokalit dhe më detyrohet.

- Vërtet?

Ajo pohoi me kokë.

- Hajde të ikim tani, se kam edhe punë të tjera!

Ai kërciu përpijetë dhe stilolapsi që mbante në dorë kërciti mbi dysheme. U përkul ta kapte, pastaj ma ktheu kërkesën që i kisha dhënë.

- Faleminderit gjithsesi, - më tha.

- Asgjë, të lutem!

- Vazhdojmë Ringo? - bërtiti Lola nga dera.

U hodh përpijetë i trembur, buzëqeshi, pastaj u përkul pak duke m'u afruar e më tha:

- Ai ende vazhdon të flasë për ty.

- Kush?

- Deksteri.

Natyrisht. Çfarë fati! Ai na qenka pikërisht në këtë grup.

- Pse? - e pyeta. - Ai as nuk më njeh.

- S'ka rëndësi, - u përgjigj duke mbledhur supet. - Tashmë ti je zyrtarisht një sfidë për të. Nuk ka për t'u dorëzuar kurrë.

Qëndroja e ulur atje, duke tundur kokën. Sa qesharake!

Ai me sa duket nuk më vuri re. I ra lehtë me dorë tryezës sikur të kishim bërë ndonjë marrëveshje apo diçka të tillë dhe u drejtua për nga Lola.

Kur u larguan, Talinga më vështroi e më pyeti:

- E njeh?

- Jo, - iu përgjigja, duke rrëmbyer telefonin teksa ra sërish. - Botë e vogël... qytet i vogël... Ishte thjesht një rastësi. Nuk e njoh.

Në javën që pasoi ndarjen time me Xhonatanin, s'para kisha menduar për të apo për Dekster muzikantin apo për ndonjë gjë tjetër përveç dasmës së mamasë sime. Kisha nevojë të humbja mendjen, jo se e kisha pohuar ndonjëherë këtë me zë të lartë.

Në fillim Xhonatani më telefononte shpesh, por pas njëfarë kohe hoqi dorë, sepse e dinte që nuk do të kthehesha kurrë me të. Kloe më thoshte se kisha marrë atë që kërkoja në të vërtetë, lirinë time, por jo tamam në mënyrën që doja. Tradhtia e tij ende më digjte. Ishte diçka që më shqetësonte e më nxirrte gjumin natën dhe nuk isha në gjendje të kujtoja çfarë ëndrre kisha parë.

Për fatin tim të mirë, duhet të merresha edhe me Lizën. Tërë javën e kaluar nuk e kishte pranuar ndarjen për asnjë çast dhe ishte e sigurt që Adami do të ndryshonte mendje. Bëmë të pamundurën ta pengonim që t'i telefononte apo t'i shkante në punë për ta takuar, sepse të gjithë e dinim që

këto gjëra nuk ndihmonin aspak në një situatë të tillë. Nëse donte ta takonte, ai do ta gjente vetë. Nëse donte të kthehej me të, ajo duhet ta linte të përpiqej shumë. E kështu me radhë.

Dhe tashmë, dasma erdhi. E lashë punën me herët, në pesë, dhe vajta në shtëpi për t'u bërë gati për darkën e provës, një ditë para dasmës. Kur iu afrova portës kryesore, u kujtova që shtëpia ishte ashtu siç e kisha lënë. Një kaos i vërtetë.

- Por është e pamundur që ata të mbërrijnë në kohë. - Mami po ulërinte, kur hyra brenda dhe lashë çelësat e mi mbi tryezë.

- Ata duhet të jenë këtu për një orë, përndryshe nuk e arrijmë dot darkën.

- Mami, - i thirra, duke e dalluar menjëherë nga zëri që ishte gati të shpërthente në lot. - Qetësohu!

- E kuptoj, - vazhdonte ajo me zërin ende të ngjirur. - Por kjo është dasma ime.

I hodha një vështrim të shpejtë dhomës së ndenjjes. Aty ishte vetëm Xhenifer-Ana, që ishte bërë gati për darkën. Ish ulur në divan e po lexonte një libër që titullohej "Të planifikosh, Të ëndërrosh", dhe në kopertinë kishte fotografinë e një gruaje të zhytur në mendime. Ngriti sytë duke kthyer faqen.

- Çfarë po ndodh? - e pyeta.

- Kompanisë së Limuzinave i kanë dalë disa probleme. - Ajo shpupurishi flokët. - Më duket se njëra nga makinat ka bërë aksident, ndërsa tjetra ka ngecur në trafik.

- Kjo nuk mund të jetë e pranueshme, - bërtiti mami.

- Ku është Krisi?

Ajo pa lart në tavan.

- Në dhomën e tij, - u përgjigj.

Me sa dukej, diçka kish ndodhur mes tyre. U ngërdhesh dhe iu kthye librit të saj.

Vëllai im mbante hardhuca. Lart, ngjitur me dhomën e tij, atje ku dikur kishte qenë një depo, tani ai kishte vendosur njëri pas tjetrit disa akuariume ku rriste hardhuca. Vështirë se mund të përshkruheshin: më të vogla se iguanat dhe më të mëdha se gekot. Gjuhën e kishin si të gjarprit dhe hanin bulktha të vegjël, që gjithnjë lëshoheshin nëpër shtëpi ku kërcenin poshtë shkallëve dhe cingërima e tyre dëgjohej, edhe pse të fshehur nëpër këpucë, brenda në dollap. Kishte edhe një inkubator, të cilin e mbante mbi dyshtemenë e dhomës së tij. Kur kishte vezë në të, ai bënte një cikël lëvizjesh tërë ditën për të mbajtur temperaturën e nevojshme për rritjen e krijesave të vockla.

Xhenifer-Ana i urrente hardhucat. Ato ishin, në fakt, e vetmja pikë ku kishte ngecur transformimi që ajo i kishte bërë Krisit, e vetmja gjë nga e cila Krisi nuk do të hiqte dorë për të. Kështu, ajo refuzonte t'i afrohej dhomës së tij dhe kur vinte në shtëpinë tonë qëndronte në divan ose ulur në tryezën e kuzhinës, zakonisht, duke lexuar ndonjë libër motivues dhe psherëtinte më zë aq të lartë sa ta dëgjonin të gjithë, me përjashtim të Krisit, që zakonisht ishte lart duke u kujdesur për krijesat e vogla.

Por tani kisha të tjera probleme.

- E kuptoj, - foli mami me zërin që tashmë po i dridhej, gati për t'ia shkrepur të qarit, - por ajo që nuk po dëgjoni është se njëqind veta do të jenë duke më pritur në "Hilton" dhe unë nuk do të mundem të shkoj aty.

- Eej, eej, eej, - i thashë teksa qëndroja prapa saj, duke e afruar dorën me kujdes te telefoni. - Mami! Lërmë mua të flas me ta!

- Kjo është qesharake, - vazhdonte të dërdëlliste mami, por ma dha telefonin. - Kjo është...

- Mami, - i fola qetë, - shko vishu! Merrem unë me këtë. Në rregull?

Qëndroi aty në këmbë për një sekondë, duke kapsitur sytë. Fustanin e kishte veshur, ndërsa getat po i mbante në dorë. Nuk e kishte bërë akoma tualetin dhe as bizhuteritë nuk i kishte vënë. Kjo do të thoshte se i duheshin edhe nja njëzet e pesë minuta të mira nëse do të ishim me fat.

- Mirë, atëherë, - tha sikur po më bënte ndonjë nder. - Lart do të jem.

- Në rregull. - E vështrova teksa doli nga dhoma duke kaluar gishtat nëpër flokë. Kur iku, e vura telefonin te veshi. - Me Albertin flas?

- Jo, - u përgjigj një zë i matur. - Jam Tomasi.

- Aty është Alberti?

- Prisni pak! - U dëgjua një zhurmë e mbytur. Dikush kapi receptorin. - Alo, jam Alberti.

- Albert, jam Remi Star.

- Hej, Remi! Dëgjo, kjo puna e makinave është bërë lëmsh, më kupton?

- Mamaja ime është bërë shumë keq, Albert.

- E di, e di. Por shiko! Këtë po përpiquej edhe Tomasi t'i thoshte. Do të veprojmë kështu...

Pas pesë minutash ngjita shkallët dhe trokita në derën e mamit. Kur hyra brenda, e pashë përpara pasqyrës duke bërë tualetin. Dukej njësoj, vetëm se kishte ndërruar fustanin dhe tashmë qëndronte e ulur, duke lyer fytyrën me furçën e grimit. Eh, ky po që ishte progres.

- Gjithçka në rregull, - i thashë. - Një makinë tjetër do të vijë këtu në gjashtë. Nesër do ta kesh limuzinën dhe kjo na intereson në të vërtetë. Si thua?

Psherëtiu, duke vendosur një rën dorë mbi kraharor, sikur kjo më në fund do t'ia qetësonte zemrën që i rrihte fort.

- Mrekulli. Faleminderit.

U ula mbi shtratin e saj, hoqa këpucët dhe i hodha një shikim orës. Ishte pesë e një çerek. Më duheshin vetëm tetëmbëdhjetë minuta për t'u bërë gati duke përfshirë këtu edhe tharjen e flokëve, kështu që u shtriva në shpinë dhe mbylla sytë. Dëgjoja mamin tek bëhej gati: shishet e parfumit tringëllonin, furçat lyenin, kremi i fytyrës dhe ai i syve zhvendoseshin mbi syprinën e tavolinës me pasqyrë ku po bënte tualetin. Mami im kishte qenë gjithnjë magjepsëse, trupvogël, por plot energji dhe e prirë për shpërthime dramatike. I pëlqente të vinte shumë byzylykë që kërcëllinin teksa tundte krahët në të katër anët kur fliste. Edhe kur jepte mësim në kolegjin e qytetit dhe shumica e studentëve ishin gjysmë të përgjumur pasi i kishin ditët shumë të ngarkuara, ajo bënte tualet, vinte parfum dhe veshjet e saj ishin elegante e me ngjyra të nderura. Flokët i lyente të zinj sterrë, tani që kishin filluar t'i thinjeshin i mbante të shkurtër me balluke të dendura të prera drejt. Me këto flokë si dhe fundet e gjata e të lirshme ajo mund të kishte qenë një geishë, po të mos ishte aq e zhurmshme.

- Remi, shpirt! - tha befaz dhe unë ngrita menjëherë kokën, duke kuptuar që pothuaj kisha ikur në gjumë. - A mund të ma mbërthesh pak?

U çova dhe iu afrova duke marrë gjerdanin që më zgjati.

- Je bërë shumë e bukur, - i thashë. Dhe ishte e vërtetë. Kishte veshur një fustan të gjatë të kuq, të hapur përpara, kishte vënë vathë me safir dhe unazën me një diamant të madh. Kishte vënë parfumin *L'air du Temps*. Kur isha e vogël mendoja se aroma e tij ishte më e mrekullueshmja në botë. Kjo aromë kish mbushur tërë shtëpinë: ngjitej nëpër

perde e qilima, njësoj si tymi i duhanit, e nuk shqitej më kurrë.

- Faleminderit, zemër, - u përgjigj pasi ia mbërtheva. Duke e parë në pasqyrë, atë dhe veten time, më bëri sërish përshtypje fakti se sa pak ngjanim me njëra-tjetrën: unë bionde dhe e hollë, ajo zeshkane dhe me një trup tërë forma. As babit nuk i ngjaja. Nuk kisha shumë fotografi të hershme të tij, por në të gjitha ato që kisha parë, ai ishte i thinjur, si këngëtarët e rokut të viteve '60-të, me mjekër dhe flokë të gjatë. Gjithashtu, dukej përherë xurxull, gjë të cilën mami kurrë nuk e kundërshtonte kur ia vija në dukje. *“Oh, ai kishte një zë aq të bukur!”*, më thoshte tani që kishte vdekur. *“Një këngë, dhe unë mbaroja fare.”*

U kthye nga unë dhe m'i mori duart në të sajat.

- Oh, Remi, - foli duke buzëqeshur. - Nuk të duket e pabesueshme? Do të jemi kaq të lumtur.

Tunda kokën.

- Natyrisht, kjo nuk është hera ime e parë që shkoj në altar.

- Jo, - u pajtova me mendimin e saj, duke ia drejtuar flokët që i ishin shpupurishur pak nga prapa.

- Por, kësaj here, më duket e vërtetë... sikur do të zgjasë përgjithmonë... Nuk të duket edhe ty kështu?

E dija se çfarë donte të dëgjonte nga unë, e megjithatë hezitova. Dukej si një film i dobët, ky ritual që e kishim provuar dy herë me sa mbaja mend unë. Tashmë, shoqërueset e tjera të nuses dhe unë i konsideronim ceremonitë më tepër si një ribashkim të nxënësve të një klase, ku, të ulura mënjanë, diskutonim kush ishte shëndoshur apo kujt i kishin rënë flokët që prej dasmës së fundit të mamit. Nuk kisha më iluzione për dashurinë. Ajo vinte, shkonte, linte viktima ose jo. Njerëzit nuk ishin të destinuar të jetonin